



Universiteti / University
"Isa Boletini" - Mitrovicë

VJETARI 2023!



PËRMBAJTJA

1.	HISTORIKU, KAMPUSI UNIVERSITAR DHE PROGRAMET E STUDIMIT.....	4
2.	MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT.....	5
3.	ORGANOGRAMI.....	6
4.	PËRBËRJA E KËSHILLIT DREJTUES.....	7
5.	PËRBËRJA E SENATIT.....	8
6.	PARLAMENTI STUDENTOR.....	9
7.	BASHKËPUNIME, PROJEKTE, MOBILITETE.....	10
8.	STATISTIKA.....	11
9.	STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË UEBFAQES SË UIBM.....	13
10.	NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2023.....	15
11.	Burhan Kavaja, ish – studenti i Shkollës së Lartë Teknike, me numër të indeksit 1, vizitoi UIBM.....	16
12.	Ass. Xhemajl Veliqi është zgjedhur Ombudsman i UIBM.....	17
13.	Tre studentë të Inxhinierisë dhe Teknologjisë Ushqimore përfitojnë nga mobiliteti në kuadër të projekteti Erasmus+ DualAFS.....	18
14.	Ndahen mirënjohje për personelin e dalluar akademik dhe administrativ.....	19
15.	UIBM bashkëpunon me Platformen Lexdoks (Legal Data Solutions L.L.C).....	20
16.	Vizitë monitoruese në UIBM për projektin ResearchCult, ErasmusPlus.....	21
17.	Gjykim i simuluar nga studentët e Fakultetit Juridik.....	22
18.	U mbajt tryeza: “Përmbajtjet dhe shkaktarët e tyre në Kosovë”.....	23
19.	U mbajt tryeza shkencore: “Sfidat dhe mundësitë e metalurgjisë së ferrolegurave në Kosovë”.....	24
20.	UIBM renditet i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë, sipas Webometrix.....	25
21.	Nismë për ndarjen e titullit “Doctor Honoris Causa” për akademik Minir Dushin.....	26
22.	FIMK anëtar themelues i iniciativës Crossscience.....	27
23.	Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.....	28
24.	Pesë studentet e UIBM-së, përfituese të programit Global Engineer Girls Kosovo.....	29
25.	Ambasadorët e UIBM-së mirëpritën në takim nga rektori, prof.dr. Alush Musaj.....	30
26.	3 studente të UIBM-së përfitojnë një semestër në Universitetin “Eastern Finland”.....	31
27.	U mbajt “Panairi për Shkencë dhe Teknologji 2023”.....	32
28.	Akademik Minir Dushi u nderua me titullin “Doctor Honoris Causa”.....	33
29.	UIBM dhe Caritasi zviceran bashkëpunojnë për projektin TAKE.....	34
30.	Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës.....	35
31.	Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, riakreditohet për periudhën 3 - vjeçare (2023-2026).....	36
32.	Avdyl Beqiri zgjedhet Sekretar i Përgjithshëm i UIBM-së.....	37
33.	Tri studente të Edukimit po marrin pjesë në programin e shkëmbimit të studentëve Erasmus + në University of Eastern në Finland.....	38
34.	Projekti QUADIC organizon ngjarjen e shpërndarjes së rezultateve të arritura.....	39
35.	Prof. Berat Ujkani nga FIMK ishte pjesë e shkollës së parë trajnuese në Kaunas University of Technology (KUT), Lituani.....	40
36.	UIBM del i dyti në kuadër të universiteteve publike në Rangimin Kombëtar të H-indeksit 2023 të Kosovës.....	41
37.	U mbajt “Dita e hapur” në UIBM.....	42
38.	Një delegacion i UIBM-it qëndroi për vizitë në University of Eastern Finland në kuadër të programit Erasmus+.....	43
39.	Ka filluar “Kongresi XIX Ballkanik i Përpunimit të Mineraleve (XIX BMPC)”.....	44
40.	Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Hotelerisë dhe Turizmit të Republikës së Kosovës.....	45
41.	Tre profesorë ndërkombëtarë po qëndrojnë në UIBM në kuadër të Programit Erasmus+.....	46
42.	U konstituua përbërja e re e Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.....	47
43.	Memorandum Mirëkuptimi me KREN – in.....	48
44.	Prof.asoc.dr. Merita Shala zgjedhet Rektore në UIBM.....	49

45.	Marrëveshje Bashkëpunimi me Salem State University nga Massachusetts, USA.....	50
46.	UIBM renditet i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë, sipas Webometriks.....	51
47.	U përurua Stacioni Hidrometeorologjik në hapësirat e UIBM.....	52
48.	Doli nga shtypi monografia “Jeta akademike në Mitrovicë (1961 -2023).....	53
49.	UIBM pjesë e Panairit të Punës.....	54
50.	U mbajt tryeza me temë: “E ardhmja e Inteligjencës Artificiale në Arsimin e Lartë”.....	55
51.	Sekretari i përgjithshëm, Avdyll Beqiri, e përfaqësoi UIBM në Konferencën e Arsimit të Lartë në Rotterdam.....	56
52.	Rektori Musaj dhe prorektoret, Shala e Avdullahi, morën pjesë në “Konferencën Ndërkombëtare të Asociacionit të Universiteteve Ballkanike – BUA”	57
53.	Memorandum bashkëpunimi për iniciativën “Thunderbird School of Global Management”.....	58
54.	Universiteti “Isa Boletini”- Mitrovicë dhe Universiteti Trakya i bashkohen marrëveshjes së bashkëpunimit akademik.....	59
55.	Prof.asoc.dr. Merita Shala, pranoi detyrën e rektores.....	60
56.	U mbajt “Dita e pritjes” për studentët e rinj.....	61
57.	UIBM pjesë e punëtorisë “Scientific Journals and Modern Research Methods”.....	62
58.	Certifikohen 39 të rinj për “WordPress dhe QA Manual Tester”.....	63
59.	Në UMIB u mbajt Shkolla Verore “Post-Mining and Transition”.....	64
60.	Rektorja Shala priti në takim drejtuesit e Parlamentit Studentor.....	65
61.	U mbajt ceremonia e diplomimit për vitin akademik 2022/23.....	66
62.	U zgjodh kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i ri i Këshillit Drejtues.....	67
63.	Pesë studente të UIBM përfunduan me sukses programin “Global Engineer Girls Kosovo”.....	68
64.	Filloi punimet “Konferenca V Ndërkombëtare Multidisciplinare për Gjeoshkencë”.....	69
65.	U mbajt ligjëratë vetëdijësuese në kuadër të “Tetorit rozë”.....	70
66.	Dekani Kutllovci dhe profesori Zeqiri, morën pjesë në punëtorinë “Ballkans Minerals Workshop”.....	71
67.	U përuruan pajisjet e reja laboratorike në UIBM.....	72
68.	U mbajt sesion informues me studentët e rinj në UIBM.....	73
69.	Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë në top 3 institucionet publike me numër të programeve të akredituara.....	74
70.	Profesori, Besim Gollopi nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, fitoi çmimin “Ambasador i Paqes”.....	75
71.	Fakulteti i Edukimit bashkëpunon me “BONEVET Mitrovica” për realizimin e mësimit praktik për studentë.....	76
72.	Një delegacion nga Universiteti “Nürtingen-Geislingen” vizitoi Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore në kuadër të projektit DualAFS.....	77
73.	Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit Juridik dhe Albanian Institute of Cultural Studies (AICS).....	78
74.	U mbajt simpoziumi për nder të “Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve”.....	79
75.	Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit Juridik dhe Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë”.....	80
76.	U themelua Trupi Këshillëdhënës në Fakultetin Juridik.....	81
77.	U mbajt konferenca finale e projektit “DualAFS”.....	82
78.	Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, mbajti ligjëratë në UIBM.....	83
79.	U mbajt Akademia Përkujtimore kushtuar prof.dr. Afrim Koliqi.....	84
80.	UIBM renditet i dyti në kuadër të universiteteve publike nga “Kosovo National H-index Ranking 2023”.....	85
81.	Prof.dr. Naser Peci nga FGJ-ja mori pjesë në takimin vjetor “Initiative for coal regions in transition in the Western Balkans and Ukraine” në Bruksel.....	86
82.	U mbajt Akademi Përkujtimore kushtuar prof.dr. Mursel Rama dhe prof.dr. Ali Sadiku.....	87
83.	Memorandum bashkëpunimi ndërmjet FTU-së, K.R.U Gjakova dhe “Kosovo Glass Recycling”.....	88
84.	Profesori i Fakultetit Juridik, prof.ass.dr. Zahir Çerkini, përfundon programin “Fulbright Visiting Scholar”.....	89
85.	Në Fakultetin e Gjeoshkencave nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me tri shkolla të mesme.....	90
86.	Stafi i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore përfundon mobilitetin në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Savonia.....	91

HISTORIKU, KAMPUSI UNIVERSITAR DHE PROGRAMET E STUDIMIT

Historiku

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë u themelua më 06 mars 2013, ndërsa ky vendim u ratifikua në Kuvendin e Kosovës më 31 maj 2013. Në momentin që u mor vendimi për themelimin, në Mitrovicë ishin duke funksionuar Fakulteti i Shkencave të Aplikuara (ish - SHLT) dhe Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë (ish - FXM). Fakultetet teknike dhe tradita mbi 50 vjeçare e arsimit të lartë në Mitrovicë si dhe programet që funksionon së fundi, ishin baza e Universitetit Publik të Mitrovicës. Në bazë të Statutit të Përkohshëm, miratuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në kuadër të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"(UMIB), siç u quajt mandej, u themeluan gjashtë fakultete: Fakulteti i Gjeoshkencave (FGJT), Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore (FTU), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK), Fakulteti Juridik (FJ), Fakulteti Ekonomik (FE) dhe Fakulteti i Edukimit (FED).

Kampusi Universitar

Përveç dy objekteve që shfrytëzohen prej fakulteteve dhe atij të rektoratit, brenda kampusit janë ndërtuar edhe mensa, konvikti dhe hapësira rekreativo-sportive. Objektet e ndërtuara kanë një sipërfaqe prej 36.004,31m² (dy objekte të njësisive akademike në sipërfaqe prej 33.509 m² dhe objekti i Administratës Qendrore - rektorati në sipërfaqe prej 2.495 m²). Mensa ka një hapësirë prej 2.920 metrash katrorë, ku mund të ushqehen deri në 500 veta njëkohësisht. Ndërsa konvikti ka hapësirë 7.896 metra katrorë dhe mund të akomodojë 279 studentë. Në vitin 2023 janë përruruar edhe fushat e sportit në kampusin universitar (dy fusha të hapura sportive, njëra e ndarë për futboll dhe tenis dhe tjetra për basketboll dhe volejbol).

Programet e Studimit

Fakulteti i Gjeoshkencave

Bachelor	Master
Xehetari	Xehetari
Gjeologji	HidroGjeologji me gjeologji inxhinierike
Maeriale & metalurgji	Materiale & metalurgji
	Vendburimet e lëndëve të para minerale

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

Bachelor	Master
Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore	Teknologji

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike

Bachelor
Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri
Inxhinieri Ekonomike
Makineri Prodhuese

Fakulteti Juridik

Fakulteti Ekonomik

Bachelor	Bachelor
Juridik	Biznes dhe Menaxhment me specializimet: 1. Banka, Financa dhe Kontabilitet; 2. Menaxhment dhe Ndërmarrësi

Fakulteti i Edukimit

Bachelor
Edukim Fillor

MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT

Misioni i UMIB-it është që të ofrojë mësimdhënie cilësore për përgatitjen e kuadrove në fusha unike për Kosovën, rajonin e më gjerë, i dedikuar të zhvillojë kërkime shkencore, projekte profesionale, këshillime profesionale duke qenë në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes të mirëqenies dhe avancimit shoqëror.


Vizioni i UMIB-it është të jetë Institucion i Arsimit të Lartë lider në rajon, në edukim dhe hulumtim shkencor, për përgatitjen e kuadrove konkurrentë në fusha unike për Kosovën dhe rajonin, për të përmbushur kërkesat e së tashmes dhe projektuar nevojat e së ardhmes, për nevojat shkencore – akademike, të ekonomisë së tregut, institucioneve e diplomacisë, i fokusuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale.

Vlerat mbi të cilat mbështetet veprimtaria e UMIB-it, janë:

- Përgjegjësi dhe respektim i ndërsjellë
- Drejtësi dhe ndershmëri
- Integritet dhe llogaridhënie
- Diversitet dhe mirëqenie
- Kreativitet dhe liri intelektuale
- Kujdesi ndaj mjedisit dhe shoqërisë

ORGANOGRAMI

Struktura Organizative e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini"



PËRBËRJA E KËSHILLIT DREJTUES

1. Prof.ass. dr. Jeton Halili – kryesues
2. Prof.dr. Lirak Karjagdiu- zëvendëskryesues
3. Prof.dr.sc. Atifete Zuna – anëtar
4. Prof. asoc. dr. Valdet Gjinovci- anëtar
5. Prof. asoc. dr. Halil Bajrami-anëtar
6. Prof. asoc. dr. Bashkim Bellaqa-anëtar
7. Ass. Fatbardha Hoxha-anëtar



PËRBËRJA E SENATIT

1. Prof.asoc.dr. Merita Shala, rektore,
2. Prof.asoc.dr. Qazim Tmava, dekan FE
3. Prof.asoc.dr. Islam Qerimi, dekan FJ
4. Prof. asoc. dr. Mensur Kelmendi, dekan FTU
5. Prof. asoc.dr. Faton Merovci, dekan FIMK
6. Prof.ass.dr. Samire Bllaca – dekane Fedu
7. Prof.asoc.dr. Festim Kutllovci – dekan FGJ
8. Prof. dr. Aziz Behrami, FTU
9. Ass. Milaim Mehmeti, FE
10. Ass. Ylli Hashani, Fedu,
11. Ass. Arbëri Krasniqi, FIMK
12. Prof.ass.dr. Mimoza Aliu, FJ
13. Prof.asoc.dr. Nazmi Hasi, FGJ
14. Alban Fazliu, administratë
15. Valton Ujkani, PS
16. Elmedina Kurti, PS
17. Avdyl Beqiri, ex officio



PARLAMENTI STUDENTOR

1. Valton Ujkani - kryetar i Parlamentit Studentor
2. Elmedina Kurti - senatore nga Parlamentit Studentor
3. Dafina Muzliukaj - sekretare e Parlamentit Studentor
4. Eranda Haxhnikaj - nënkryetare e Parlamentit Studentor
5. Albina Tahiri - nënkryetare e Parlamentit Studentor



BASHKËPUNIME, PROJEKTE, MOBILITETE


1. Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë
2. Bashkëpunim me “Caritasin zviceran” për projektin TAKE
3. Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin Evropian të Tiranës
4. Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Turizmit dhe Hotelerisë të Republikës së Kosovës
5. Memorandum Mirëkuptimi me KREN
6. Memorandum Bashkëpunimi me “Salem University” nga Massachusetts SHBA
7. Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin e Takya
8. Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin e Tuzllës
9. Memorandum Bashkëpunimi me “BONEVET Mitrovica”
10. Memorandum Bashkëpunimi mes Fakultetit Juridik dhe “Albanian Institute of Cultural Studies” (AICS)
11. Memorandum Bashkëpunimi mes FTU dhe KRU Gjakova dhe “Kosovo Glass Recycling”
12. Fakulteti Juridik anëtarësohet në platformën “Lexdoks”
13. FIMK anëtar themelues i iniciativës “Crosscience”
14. UIBM përfaqësohet në “International Staff Eëek”
15. Sekretari i përgjithshëm i UIBM, Avdyl Beqiri, mori pjesë në Konferencën e Arsimit të Lartë në Rotherdam të Holandës
16. Pajisje të reja për laboratorët përmes projektit të fituar nga “HERAS”
17. Është vazhduar projekti CEEPUS III “Social Impact of Distance Learning”
18. Fakulteti i Edukimit fiton projekt në kuadër të projektit “KUSA”
19. Tre studentë qëndruan për mobilitet në Finlandë
20. Stafi akademik i FIMK-ut morën pjesë në shkollën e parë trajnuese në Lituani
21. Gjashtë anëtarë të stafit akademik dhe administrativ kanë qenë për vizitë në Finlandë në kuadër të Erasmus+
22. Tre profesorë kanë qenë për vizitë në kuadër të projektit “Erasmus+”
23. Është fituar projekti për mobilitet për 9 persona nga stafi akademik dhe studentë me Universitetin e Lubjanës
24. Tre studentë përfunduan mobilitetin në kuadër të “Erasmus+ DualAFS” në Savonia të Finlandës
25. Profesori, Zahir Çerkini, ka fituar bursën “FulBright Visiting Scholar”
26. U mbajt shkolla verore “Post Mining and Transition” në UIBM
27. Pesë studentë përfunduan me sukses programin “Global Engineer Girls Kosovo”
28. Profesoresha, Mirsade Osmani, fituese e bursës për mobilitet në Savonia të Finlandës në kuadër të projektit Erasmus+ DualAFS.

STATISTIKA

Pasqyra grafike e studentëve vendorë sipas qyteteve

Niveli Të gjitha nivelet e studimeve
Fakulteti Të gjitha fakultetet
Departamenti Të gjitha departamentet
Viti akademik 2023/2024
Afati

- Gjakovë
- Glllogoc
- Gjilan
- Istog
- Klinë
- Kamenicë
- Mitrovicë
- Obiliq
- Pejë
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Skënderaj



▲ 1/2 ▼




UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" MITROVICË

Tel.: +38328515516, Fax: +38328515516, Adresa: Rr. Ukshin Kovaçica, 40000 Mitrovicë

Numri i studentëve aktiv sipas viteve të studimeve dhe totali : 2023/2024

Viti i studimeve	1			2			3			4			Total
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	
Fakulteti Ekonomik	61	39	22	43	20	23	68	41	27	0	0	0	172
Fakulteti i Edukimit	43	42	1	34	33	1	42	41	1	111	111	0	230
Fakulteti i Gjeoshkencave	140	95	45	59	23	36	45	9	36	0	0	0	244
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	377	271	106	159	101	58	116	61	55	0	0	0	652
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	161	136	25	108	85	23	97	79	18	0	0	0	366
Fakulteti Juridik	80	65	15	44	38	6	49	44	5	75	57	18	248
Total	862	648	214	447	300	147	417	275	142	186	168	18	1912


- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Gjeoshkencave
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore
- Fakulteti Juridik



Numri i studentëve të diplomuar : 2022/2023 - Bachelor

	Total	F	M	Total
Fakulteti Ekonomik	22	14	8	22
Fakulteti i Edukimit	65	63	2	65
Fakulteti i Gjeoshkencave	15	7	8	15
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	42	21	21	42
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	21	18	3	21
Fakulteti Juridik	21	16	5	21
Total	186	139	47	186


- Fakulteti Ekonomik
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti i Gjeoshkencave
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore
- Fakulteti Juridik




Numri i studentëve të diplomuar : 2022/2023 - Master

	Total	F	M	Total
Fakulteti i Gjeoshkencave	6	2	4	6
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	9	8	1	9
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	7	5	2	7
Total	22	15	7	22

- Fakulteti i Gjeoshkencave
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore



STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË UEBFAQES SË UIBM




STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË UEBFAQES SË UIBM

	Page title	Views
1.	Universiteti "Isa Boletini"- Ballina	177,490
2.	Fakulteti i Edukimit - Universiteti "Isa Boletini"	12,766
3.	(not set)	11,729
4.	Fakulteti i Inzhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike - Universiteti i Mitrov...	11,280
5.	Home - Universiteti "Isa Boletini"	10,246
6.	Konkurse - Universiteti "Isa Boletini"	9,931
7.	Fakulteti Teknologji Ushqimore - Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	8,468
8.	Stafi akademik - Universiteti "Isa Boletini"	7,897
9.	Fakulteti Juridik - Universiteti "Isa Boletini"	7,289
10.	Fakulteti i Çjezhkencave- Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini"	6,941
11.	Shpallje - Universiteti "Isa Boletini"	6,517

1 - 100 / 8698 < >

	Device category	Views
1.	mobile	249,113
2.	desktop	194,656
3.	tablet	1,009

1 - 4 / 4 < >



	Country	Views
1.	Kosovo	17,592
2.	Albania	6,358
3.	Serbia	1,125
4.	Germany	513
5.	United States	380
6.	Italy	175
7.	Switzerland	172
8.	Sweden	140
9.	North Maced...	137

1 - 68 / 68 < >

	Language	Views
1.	English	408,308
2.	Albanian	16,847
3.	German	9,347
4.	Turkish	1,444
5.	French	1,335

1 - 48 / 48 < >

NGJARJET KRYESORE TË VITIT 2023

UIBM renditet i dyti në kuadër të universiteteve publike në vend në ranglistën e “Indeksit shkencor AD”

12.01.2023

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është renditur i dyti në kuadër të universiteteve publike në Kosovë në “Indeksin shkencor AD”. Ky indeks është një sistem renditjeje dhe analize i bazuar në performancën shkencore dhe vlerën e shtuar të produktivitetit shkencor të shkencëtarëve individualë.

Janë 64 shkencëtarë nga UIBM në mesin e 1000 top shkencëtarëve nga universitetet dhe kolegjet private në Kosovë, që janë bërë pjesë e këtij indeksi. Kjo është mirëpritur nga drejtuesit e UIBM që kanë vlerësuar angazhimin dhe punën e mirë të personelit akademik.



Burhan Kavaja, ish – studenti i Shkollës së Lartë Teknike, me numër të indeksit 1, vizitoi UIBM



Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, ka pritur në takim ish-studentin e Shkollës së Lartë Teknike (SHLT), Burhan Kavaja, i cili ka pasur indeksin me numër 1. Rektori Musaj, ka shprehur kënaqësinë për vizitën dhe takimin me ish -studentin e SHLT-së, i cili më vonë kishte mbajtur pozita të ndryshme në ndërmarrjet më të mëdha vendore, duke përfshirë edhe kombinatin “Trepça”. Në takim rektori shprehu mirënjohjen e tij për punën dhe angazhimin e Kavajës, i cili për 12 vjet me radhë ishte i angazhuar edhe si mësimdhënës në Fakultetin e Xehetarisë dhe Metarlurgjisë. “Jemi të lumtur që kemi në mesin tonë një ish-student dhe mandej profesor të institucioneve akademike që kanë qenë në Mitrovicë”, tha Musaj.

Ass. Xhemajl Veliqi është zgjedhur Ombudsman i UIBM



Senati i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), në mbledhjen e mbajtur më 17 janar 2023, ka zgjedhur Ass. Xhemajl Veliqin për Ombudsman të këtij institucioni të lartë akademik në vend. Ombudsmani i UIBM është kompetent për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të stafit akademik, administrativ dhe studentëve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të Universitetit.

Tre studentë të Inxhinierisë dhe Teknologjisë Ushqimore
përfitojnë nga mobiliteti në kuadër të projekteti Erasmus+
DualAFS



Në kuadër të projektit Erasmus+ DualAFS, tre studentë të Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM): Sofije Istrefi, Florina Musaj, dhe Berna Zejnullahu, kanë filluar mobilitetin në semestrin veror në “Savonia University of Applied Sciences”, Finlandë. Sipas projektit, këta studentë do të qëndrojnë atje nga 9 janar – 7 prill 2023.

Ndahen mirënjohje për personelin e dalluar akademik dhe administrativ



Në një ceremoni të organizuar të enjten në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), janë ndarë mirënjohje për personelin e dalluar akademik dhe atë administrativ. Mirënjohjet i ka ndarë rektori, prof.dr. Alush Musaj, ndërsa kanë qenë të pranishëm edhe prorektorët e UIBM.

Prof.asoc.dr. Faton Merovci, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) është nderuar me mirënjohje si shkencëtari numër 1 në UIBM, bazuar në rangimin e Kosovo Top 1000 Scientists “AD Scientific Index 2023” Eorl Scientist and University Rankings 2023. Prof. asoc. dr. Mehush Aliu u nderua me mirënjohje si mësimdhënësi i vlerësuar më së larti nga studentët, ndërsa prof.dr. Zarife Bajraktari Gashi, për kontributin në intensifikimin e bashkëpunimit Industri-Universitet. Drejtori i Teknologjisë Informative, Lulzim Bunjaku, u nderua me mirënjohje për digjitalizimin e kampusit universitar.

UIBM bashkëpunon me Platformen Lexdoks (Legal Data Solutions L.L.C)



Dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi dhe drejtori menaxhues i “Legal Data Solutions L.L.C., AlbanKrasniqi, kanë nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me qëllim që shërbimet e Platformës Lexdoks të ketë drejtë t’i shfrytëzojë pa pagesë UIBM, për një periudhë kohore prej 6 muajsh, për të cilën dekani i shprehu falenderim të veçantë. Lexdoks është platformë e inteligjencës artificiale kërkimi që do t’i mundëson stafit akademik dhe studentëve të UIBM, qasje të shpejtë në të gjithë dokumentet e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore të Republikës së Kosovës, duke i bërë ato elektronikisht të kërkueshme, lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme për citim. Kjo Platform veçohet sidomos për faktin se sistemin tonë ligjor e bën më transparent dhe më të qasshëm.

Vizitë monitoruese në UIBM për projektin ResearchCult, ErasmusPlus



Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ishin për vizitë monitoruese përfaqësuesja e Universitetit Sapienza të Romës (Itali), Prof. Fiorenza Deriu dhe përfaqësuesi i IBCM, koordinatori i projektit, prof. Bujari Gallopeni. Ata u pritën nga prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Hulumtime, prof. dr. Behxhet Shala, dekani i Fakultetit të Edukimit dhe koordinatori lokal i projektit, Prof. sc. dr. Besim Gollopeni dhe Ass. Arbër Hyseni, koordinatori i zyrës për hulumtime në UIBM.

Gjykim i simuluar nga studentët e Fakultetit Juridik

Pesë grupe studentësh kanë marrë pjesë të enjten në një gjykim të simuluar të organizuar në Fakultetin Juridik në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), ku objekt trajtimi ishte një rast nga e drejta penale. Pjesë e organizimit të këtij aktiviteti me studentë përveç Fakultetit Juridik ishin edhe përfaqësues të institucioneve të drejtësisë në Kosovë, si nga gjykatat, prokuroria, shërbimi korrektues, avokatia, policia etj, përderisa të pranishëm ishin dekanë, mësues, studentë dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave të ndryshme.

Dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi, ka falënderuar bashkëorganizatorët dhe të pranishmit në gjykimin e simuluar. “Fakulteti Juridik si prioritet të veçantë ka shpallur ndërmarrjen e një reforme tërësore për të krijuar një sistem në kuptimin e një formimi, kualifikimi akademik dhe trajnimi cilësor profesional në harmoni me standardet që presim të sjellim në sistemin e arsimit universitar”, tha ai.



U mbajt tryeza: “Përmbytjet dhe shkaktarët e tyre në Kosovë”



Organizuar nga Fakulteti i Gjeoshkencave (FGJ) në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u mbajt të premtën tryeza: “Përmbytjet dhe shkaktarët e tyre në Kosovë”. Përveç drejtuesve, mësime dhënë dhe studentëve të FGJ-së si dhe njësive tjera akademike në UIBM, ishin të pranishëm edhe drejtues dhe përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore.

Tryezën e hapi dekani i FGJ-së, prof.dr. Naser Peci, i cili i falënderoi pjesëmarrësit në këtë aktivitet për të trajtuar një temë aktuale sikur vërshimet, me të cilat u përballën shumë qytete të Kosovës këto ditë. Ai theksoi se trajtimi shkencor i kësaj problematike ka një rëndësi të veçantë për shoqërinë në përgjithësi dhe për institucionet veç e veç.

U mbajt tryeza shkencore: “Sfidat dhe mundësitë e metalurgjisë së ferrolegurave në Kosovë”

Në Fakultetin e Gjeoshkencave u mbajt të martën tryeza shkencore: “Sfidat dhe mundësitë e metalurgjisë së ferrolegurave në Kosovë”, ku përveç drejtuesve, mësimdhënësve dhe studentëve të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) ishin të pranishëm edhe drejtues dhe përfaqësues të ndërmarrjeve të ndryshme publike dhe private në Kosovë. Tryeza shkencore u mbajt në kuadër të aktiviteteve nga “Programi për Universitetet e Kosovës”, gjegjësisht projektit “QAIN’T”, mbështetur nga Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).



UIBM renditet i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë, sipas Webometrix

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) vazhdon të mbaj vendin e dytë në mesin e universiteteve publike në Kosovë në ranglistën e ëebometrix. Në përditësimin e fundit të publikuar nga Webometrics (Spanish National Research Council), në mesin e 29 mijë universiteteve nga i gjithë globi, UIBM është renditur në vendin e 12 573. Krahasuar me periudhën e njëjtë të para një viti UIBM është ngritur për 589 vende, ndërsa nga përditësimi i fundit në korrik 2022 është ngritur për 336 vende. Kjo është mirëpritur nga drejtuesit e UIBM, të cilët thonë se tashmë institucioni është i konsoliduar dhe i fokusuar tërësisht në ngritjen e cilësisë.



Nismë për ndarjen e titullit “Doctor Honoris Causa” për akademik Minir Dushin

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, pas konsultimeve me menaxhmentin, mësimdhënësit dhe personalitete të jetës akademike në Mitrovicë, ka marrë nismën për ndarjen e titullit “Doctor Honoris Causa” për akademikun Minir Dushi, i cili ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për zhvillimin e arsimit të lartë në Mitrovicë. Ideja është që ky çmim për akademikun të ndahet me rastin e 10 vjetorit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Rektori Musaj, e ka vizituar akademikun Dushi në shtëpinë e tij në Prishtinë, me të cilin ka biseduar për këtë nismë. “Është e jashtëzakonshme që kemi mundësinë të nderojmë një personalitet me emrin e të cilit ndërlidhet jeta akademike në Mitrovicë, prej hapjes së Shkollës së Lartë Teknike në vitin 1961 e tutje”. Akademik Dushi është shprehur jashtëzakonisht i prekur dhe shumë mirënjohës për nismën që ai të nderohet me titullin “Honoris Causa” nga UIBM.



FIMK anëtar themelues i iniciativës Crossscience

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike (FIMK) nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është bërë pjesë e iniciativës Crossscience (program i mbështetjes nga Qendra për Transformim Digital në ITP), që është lansur më 2 shkurt 2023. Iniciativa synon t’i bashkoj universitetet publike dhe intitucionet tjera të arsimit të lartë në dobi të studentëve të tyre të Shkencave Kompjuterike.

Dekani i FIMK-ut, prof. asoc. dr Faton Merovci dhe shefi i Departementit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Ass. Berat Ujkani, kanë marrë pjesë në lasimin e kësaj iniciative, ku u nënshkrua edhe marrëveshja e bashkëpunimit në mes të FIMK dhe ITP. Iniciativa ndërtohet nga tri komponente si në vijim: Talent Pool, Innovators Program dhe ICT Gateway.



03.02.2023

Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunojë me Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë (UHZ) me qëllim të zhvillimit akademik dhe aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe kulturore. Për të specifikuar fushat e bashkëpunimit, rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj dhe homologu i tij nga Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, prof.dr. Armand Krasniqi nënshkruan të hënën në UIBM një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Sipas marrëveshjes, bashkëpunimi do të mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë dhe lirinë akademike të të dyja palëve. Palët janë zotuar që të marrin në shqyrtim nevojat e përbashkëta gjatë bashkëpunimit të tyre me qëllim për të përfituar nga zhvillimi dhe shkëmbimi shkencor, edukativ dhe kulturor. Të dy rektorët shprehën kënaqësinë për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy universiteteve. Rektori Musaj, e falënderoi homologun e tij nga UHZ për vizitën dhe gatishmërinë për bashkëpunim me interes reciprok për të dy institucionet. Ndërsa, rektori Krasniqi, theksoi se bashkëpunimi ndërmjet universiteteve do të krijojë mundësi më të mëdha për studentët dhe mësuesit e dy palëve.



Pesë studentet e UIBM-së, përfituese të programit Global Engineer Girls Kosovo



Prorektorja për mësim, çështje të studentëve dhe zhvillim të cilësisë Prof.asoc. Merita Shala dhe pesë studentet Elma Sallahu, Shpresa Bajrami, Albina Demaku, Blerta Jusufi dhe Bleona Feka, morën pjesë në ceremoninë zyrtare të lansimit të projektit “Global Engineer Girls Kosovo”, i cili mundësohet nga partneriteti ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, UNDP Kosovo, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe LIMAK Kosovo. Ky program synon zhvillimin e shkathtësive ekstrakurrikulare për studentet vajza dhe gra në universitete, me qëllim përgatitjen e tyre për tregun e punës.


Në Ditën e Vajzave dhe Grave në Shkencë, “Global Engineer Girls Kosovo” nderoi studentet përfituese me nga një tablet. Përfitueset ishin edhe 5 studentenga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, 10 studente nga Universiteti i Prishtinës dhe 5 nga Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

Ambasadorët e UIBM-së mirëpriten në takim nga rektori, prof.dr. Alush Musaj



Rektori i Universitetit Prof.dr. Alush Musaj, ka filluar serinë e takimeve me ambasadorët e UIBM. Takimi i parë u zhvillua me disa anëtarë të stafit akademik, nga të cilët disa janë bartës të projekteve ndërkombëtare, disa po kryejnë studimet e tyre pos-doktorale në universitetet evropiane e më gjerë, disa janë pjesëmarrës të programit Fulbright, ndërsa disa edhe pjesëmarrës në programe të mobilitetit.

Takimi i karakterizua nga një bashkëbisedim kolegial në të cilin rektori Musaj shprehu falënderimin e universitetit duke thënë se “avancimi juaj i vazhdueshëm akademik, shkencor e profesional, përbëjnë vlera me të cilat Universiteti ynë krenohet. Jam i bindur që po ashtu përcillni vlerat dhe praktikat më të mira të UIBM-së në çdo bashkëpunim tuajin ndërkombëtar, çka ju bën të jeni ambasadorët tanë më të mirë”.



**3 studente të UIBM-së përfitojnë një semestër
në Universitetin “Eastern Finland”**

Erasmus+

Në kuadër të programit Erasmus+, përkatësisht bashkëpunimit me Universitetin e “Eastern Finland” në Finlandë, tri studente nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin “Isa Boletini”, do qëndrojnë për një semestër në Finlandë. Studentet që do të marrin pjesë në mobilitet janë: Gresa Tahiri, Pranvera Mehmeti dhe Vlera Qerkini.

U mbajt "Panairi për Shkencë dhe Teknologji 2023"

Me rastin e 10 -vjetorit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë (UIBM), Parlamenti Studentor dhe Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) kanë organizuar "Panairin për Shkencë dhe Teknologji". Panairi që tashmë është tradicional ka ofruar mundësi për nxënësit e shkollave të mesme dhe të rinjtë në përgjithësi që të njihen me kushtet dhe mundësitë që ofron UIBM.



Akademik Minir Dushi u nderua me titullin “Doctor Honoris Causa”



Në një manifestim me rastin e 10 – vjetorit të themelimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), akademik Minir Dushi, është nderuar me titullin “Doctor Honoris Causa”. Vendimi për ndarjen e titullit është marrë nga Senati i UIBM me propozim të rektorit, prof.dr. Alush Musaj, me motivacion për kontribut në themelimin dhe ngritjen e institucioneve të arsimit të lartë në Mitrovicë dhe zhvillimin e jetës akademike në Kosovë.

Në këtë ngjarje të organizuar në UIBM, përveç drejtuesve dhe përfaqësuesve të institucioneve lokale dhe qendrore, të pranishëm ishin edhe rektorë dhe profesorë nga universitetet e Kosovës, të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Gjithashtu pjesë e manifestimit ishin edhe ish – mësimdhënës dhe ish -studentë të institucioneve të arsimit të lartë në Mitrovicë. Pas shfaqjes së një filmi dokumentar për rrugëtimin 62 vjeçar të jetës akademike në Mitrovicë, të pranishmëve me një fjalë rasti ju drejtua rektori, prof.dr. Alush Musaj. Ai tha se themelimi i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, para 10 vjetësh ishte kurorëzim i një rrugëtimi prej gjysmë shekulli të jetës akademike. “Ishte një ëndërr e realizuar e gjeneratave të tëra që ishin pjesë e institucioneve të arsimit të lartë në qytetin buzë Ibrit”.

Biografinë e akademikut Minir Dushi e ka lexuar prorektorja për Mësim, Çështje të Studentëve dhe Zhvillim të Cilësisë, prof.asoc.dr. Merita Shala, ndërsa rektori Musaj e ka ndarë titullin “Doctor Honoris Causa” për akademikun Dushi. Pasi ka pranuar titullin e ndarë nga UIBM, akademik Dushi, ka falënderuar rektorin Musaj për nderimin dhe respektin e treguar ndaj tij.

UIBM dhe Caritasi zviceran bashkëpunojnë për projektin TAKE

Më 27.03.2023, në ambientet e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Caritasin zviceran në Kosovë në kuadër të projektit “Avancimi i Përbashkët i Trajnimeve dhe Punësimit në Sektorin e Arsimit në Kosovë (TAKE)”. Marrëveshjen nga Universiteti “Isa Boletini” e nënshkroi prof.dr. Alush Musaj, rektor dhe prof.assoc.dr. Besim Gollopi, dekan i Fakultetit të Edukimit, ku edhe do të realizohet projekti, ndërsa nga Caritasi Zviceran nga z. Gerhard Schaumberger, drejtor i Caritas-it dhe menaxherja e projektit TAKE, znj. Gjylbehare Llapi.

Projekti TAKE synon ofrimin e praktikës për studentët dhe të diplomuarit në drejtimin e edukimit parashkollor të Fakultetit të Edukimit, organizimin e seminareve për krijimin e një kuadri për praktikant pedagogjike, rishikimin dhe avancimin e udhëzuesit për praktikant pedagogjike, zhvillimin e një programi për procesin e monitorimit të praktikave pedagogjike, zhvillimi i moduleve për rikualifikimin e asistentëve të edukimit parashkollor, krijimi i materialeve dhe trajnimeve didaktike për prindërit dhe një mori aktivitësh të tjera që çojnë në ngritjen e cilësisë së edukimit parashkollor.



Memorandum Bashkëpunimi me Universitetin European të Tiranës


Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunojë me Universitetin European të Tiranës (UET), në fusha të caktuara ku të dyja palët ushtrojnë aktivitetet e tyre kryesore. Për të përcaktuar fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve të arsimit të lartë, të martën u nënshkrua edhe një Memorandum Bashkëpunimi nga rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj dhe rektori i UET, prof.dr. Tonin Gjuraj.

Sipas Memorandumit të Bashkëpunimit, pikat kryesore ku do të fokusohet bashkëpunimi do të jenë: Kualifikimi i specializimeve, konsulenca, praktika profesionale dhe mbështetja për punësim, projektet studimore si dhe partneritete në projekte të ndryshme. Sa i përket të drejtave dhe obligimeve, institucionet marrin përsipër që në përpunime me interesat institucionale, mundësitë e tyre dhe kapacitetet përkatëse, të vendosin në dispozicion të njëra-tjetrës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale për arritjen e qëllimeve që parashikon Memorandumi i Bashkëpunimit.



**Universiteti
European i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, riakreditohet për periudhën 3 - vjeçare (2023- 2026)

Në mbledhjen e Këshillit Shtetëror për Cilësi (KSHC), të mbajtur të martën (28 mars 2023), është miratuar raporti i ekspertëve ndërkombëtarë për riakreditimin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Miratimi i vendimit për riakreditimin e UIBM për periudhën 3 - vjeçare (2023 - 2026) është konfirmuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).

Lajmi për riakreditim është mirëpritur nga të gjitha strukturat e UIBM. Rektori prof.dr. Alush Musaj, tha se kjo është një ditë e gëzuar meqë është punuar shumë që UIBM të konsolidohet dhe të kalojë nëpër proceset e akreditimeve pa ndonjë problem. Me këtë rast, ai shprehu respektin për angazhimin e të gjitha strukturave që kanë qenë të përfshira në procesin e riakreditimit institucional. “Dua të falënderoj dhe uroj secilin që ka qenë pjesë e procesit dhe që është angazhuar që UIBM të dal sa më mirë, duke filluar nga Këshilli Drejtues, Senati, prorektorët, dekanët, stafi akademik, administrata, studentët, drejtuesit e kompanive publike dhe private, organizatat vendore dhe ndërkombëtare, që kanë qenë vazhdimisht me ne”, tha rektori Musaj.

Avdyl Beqiri zgjedhet Sekretar i Përgjithshëm i UIBM-së

Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, me shumicë të votave ka zgjedhur z. Avdyl Beqiri për Sekretar të Përgjithshëm të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Sipas statutit, Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është zyrtari më i lartë administrativ i institucionit dhe është udhëheqës i Administratës Qendrore të Universitetit. Mandati i sekretarit është 4 vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

Z. Beqiri ka kryer studimet themelore dhe ato postdiplomike në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Ka certifikime të ndryshme profesionale nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare në fushën e administratës publike dhe sistemit të drejtësisë. Më herët ka qenë Sekretar në Fakultetin Juridik të UIBM-së, me ç’rast për disa vite me radhë është shpërblyer me mirënjohje si punëtor i dalluar për shërbim profesional dhe efektiv në organizimin e administratës dhe bashkëpunimin me stafin akademik. Nga muaji dhjetor i vitit 2022 ka kryer detyrën e ushtruesit të detyrës së sekretarit të universitetit.



Tri studente të Edukimit po marrin pjesë në programin e shkëmbimit të studentëve Erasmus + në University of Eastern në Finland

Studentet e Fakultetit të Edukimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM): Gresa Tahiri, Pranvera Mehmeti dhe Vlera Çerkini, janë duke marrë pjesë në programin e shkëmbimit të studentëve Erasmus + në Finlandë. Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare zhvilloi një takim online në Google Meet me këto studente për të diskutuar përvojat e tyre të deritanishme. Studentet treguan se janë përshtatur mirë me jetën në Finlandë dhe se lëndët atje janë sfiduese, por interesante. Ato po bëjnë përparim të mirë akademik si dhe janë angazhuar në disa aktivitete dhe ngjarje jashtë universitetit. Gjithashtu shprehën mirënjohjen e tyre lidhur me mbështetjen e ofruar nga UIBM, por edhe nga Universiteti në Finlandë.



Projekti QUADIC organizon ngjarjen e shpërndarjes së rezultateve të arritura

Rektori i Universitetit Prof.dr. Alush Musaj, ka marrë pjesë të premtën në ngjarjen e organizuar nga projekti QUADIC për shpërndarjen e rezultateve të arritura, ngjarje që u zhvillua në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Rektori Musaj, e vlerësoi impaktin e këtij projekti në zhvillimin e jetës akademike në UIBM dhe sidomos në fuqizimin e bashkëpunimit lokal dhe ndërkombëtar të universiteteve partnere, duke shprehur njëkohësisht gatishmërinë dhe ambicien e UIBM për të kontribuar në vazhdim si pjesë e konsorciumeve të mundshme në bashkëpunime dhe projekte të radhës.

“Ky projekt ka ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, ka fuqizuar aspektin e hartimit të politikave dhe instrumenteve përkrahëse si dhe ka ngritur kapacitetet administrative dhe akademike në fushën e bashkëpunimeve dhe projekteve ndërkombëtare”, tha rektori Musaj. Në kuadër të kësaj ngjarje të gjithë partnerët prezantuan të arriturat në Universitetet e tyre respektive, të cilat kanë qenë direkt të ndikuara nga ky projekt.



Prof. Berat Ujkani nga FIMK ishte pjesë e shkollës së parë trajnuese në Kaunas University of Technology (KUT), Lituani

Në kuadër të projektit hulumtues MultipleYE, u mbajt shkolla e parë trajnuese më 26–28 prill 2023, në Kaunas University of Technology (KUT), Lituani. Në mesin e pjesëmarrësve nga shumë universitete evropiane ishte edhe shefi i Departamentit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, prof. Berat Ujkani.

Projekti MultipleYE synon të nxisë një rrjet ndërdisiplinor të grupeve kërkimore që punojnë në mbledhjen e të dhënave të gjurmimit të syve nga leximi në shumë gjuhë. Qëllimi është mbështetja e zhvillimit të një korpusi të madh shumëgjuhësh për gjurmimin e syve dhe t'u mundësojë studiuesve të mbledhin të dhëna duke shkëmbyer infrastrukturën dhe njohuritë e tyre midis fushave të ndryshme, duke përfshirë gjuhësinë, psikologjinë dhe shkencat kompjuterike. Ky koleksion i të dhënave mund të përdoret më pas për të studiuar përpunimin e gjuhës njerëzore nga një perspektivë psikolinguistike, si dhe për të përmirësuar dhe vlerësuar përpunimin e gjuhës kompjuterike nga këndvështrimi i machine learning.



UIBM del i dyti në kuadër të universiteteve publike në Rangimin Kombëtar të H-indeksit 2023 të Kosovës

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) ka dalur në vendin e dytë në kuadër të universiteteve publike në Rangimin Kombëtar të H-indeksit 2023 të Kosovës. Është fjala për një renditje të pavarur ndërkombëtare që synon të vlerësojë produktivitetin shkencor të shkencëtarëve, grupeve kërkimore dhe organizatave në Kosovë bazuar në indeksin e konsoliduar Hirsch.

Renditja merr në konsideratë indeksin e përgjithshëm Hirsch të institucioneve shkencore, duke adresuar informacionin nga bazat e të dhënave dhe platformat shkenometrike si Scopus, Web of Science dhe Google Scholar. Bazuar në këto të dhëna, formohet treguesi kombëtar i renditjes H-indeks. UIBM ka vite që del në vendin e dytë në kuadër të universiteteve publike edhe në ranglistën që publikohet nga Webometrix.



U mbajt “Dita e hapur” në UIBM



Parlamenti Studentor dhe Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZHK) kanë organizuar të enjten “Ditën e hapur” në kampusin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) për maturantët dhe të rinjtë që duan të studiojnë në këtë institucion të arsimit të lartë. Për pjesëmarrësit janë dhënë informata të detajuara për programet e studimit, hapësirat universitare dhe perspektivën e tyre.

Gjithashtu gjatë gjithë ditës ka pasur edhe aktivitete rekreativo– sportive, pjesë e të cilave, përveç drejtuesve të Parlamentit Studentor janë bërë edhe pjesëmarrësit. Ky aktivitet është organizuar në kuadër të fushatës informuese për të studiuar në UIBM, që ka filluar ditë më parë nëpër shkollat e rajonit.

Një delegacion i UIBM-it qëndroi për vizitë në University of Eastern Finland në kuadër të programit Erasmus+

Me mbështetjen e programit Erasmus+ dhe në kuadër të marrëveshjes për mobilitet, për trajnime dhe për mësimdhënie mes Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe University of Eastern Finland, një grup i stafit akademik të UIBM, Merita Shala, Nyrten Deva, Zahir Çerkini, Përparim Gruda, Albana Sadiku, Fatbardha Hoxha dhe Arif Krasniqi fituan mobilitetin njëjavor në University of Eastern Finland. Gjatë vizitës së tyre ata do të marrin pjesë në trajnimet e organizuara nga specialistët e fushave specifike, të cilat kanë të bëjnë me mësimdhënien dhe me procesin e tij, me përdorimin e platformave antiplagjiaturë, si dhe me ndërkombëtarizimin e Universitetit në programet bachelor dhe master. Gjithashtu, në këtë mobilitet merr pjesë edhe sekretari i përgjithshëm i Universitetit “Isa Boletini”, Avdyl Beqiri, i cili, përveç trajnimeve, do të zhvillojë takime të ndryshme me personat përgjegjës të administratës qendrore të University of Eastern Finland, si dhe me Ombudspersonin e UEF. Në kuadër të këtij mobiliteti do të shihen edhe mundësitë për bashkëpunime të mundshme midis dy universiteteve, si projekte të përbashkëta kërkimore, nisma akademike dhe vazhdim të programeve të shkëmbimit të studentëve dhe stafit.



25.05.2023

Ka filluar “Kongresi XIX Ballkanik i Përpunimit të Mineraleve (XIX BMPC)”

Ka filluar në Mitrovicë, “Kongresi XIX Ballkanik i Përpunimit të Mineraleve (XIX BMPC)”, i cili për herë të parë po mbahet në Kosovë. Organizatorë të këtij edicioni që do të zgjas dy ditë dhe mbahet në hotelin “Palace”, janë Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) dhe Instituti i Pasurimit të Mineraleve dhe Mbetjeve, Energjisë dhe Mjedisit.

Gjithashtu organizimi është mbështetur edhe nga Ministria e Ekonomisë, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, Departamenti i Minierave, “Trepça”, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), NeëCoFerronikeli, SharrCem etj. Në këtë edicion janë të pranishëm drejtues të institucioneve shkencore nga vende të ndryshme si dhe hulumtues shkencorë, të cilët do t'i paraqesin kumtesat e tyre në seanca të ndara.

Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, prof.dr. Naser Peci, tha se mbajtja e “Kongresit XIX Ballkanikë Përpunimin e Mineraleve”, në qytetin e Mitrovicës është mjaft i përshtatshëm duke pasur parasysh temën e kongresit “Përpunimi i mineraleve në sfidën globale”. “Rajoni i Mitrovicës është i njohur jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan e më gjerë sa i përket hulumtimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të mineraleve, bazuar në resurset e shumta minerale kryesisht Pb-Zn dhe metaleve tjera – që lidhet ngushtë me kompaninë “Trepça”.



29.05.2023

Memorandum Bashkëpunimi me Odën e Hotelierisë dhe Turizmit të Republikës së Kosovës

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunojë me Odën e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK) me qëllim të zgjerimit të veprimtarisë së përbashkët akademike dhe aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe kulturore. Rektori i UIBM, Prof.Dr. Alush Musaj dhe Prorektorja për buxhet dhe financa Prof. Asoc. Dr. Ajtene Avdullahi mirëpritën sot Kryetarin e Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Republikës së Kosovës Prof. Ass. Dr. Hysen Sogojeva, si dhe përfaqësuesin e bizneseve në sektorin e Hotelierisë dhe Turizmit në regjionin e Mitrovicës Z. Naim Sylejmani. Në këtë takim u bisedua për mundësitë e shumta të bashkëpunimit të Universitetit me komunitetin e biznesit në sektorin e hotelierisë dhe turizmit.

Për të specifikuar fushat e bashkëpunimit, rektori Musaj dhe kryetari i Odës profesori Sogojeva nënshkruan në UIBM memorandum bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve.

30.05.2023



Tre profesorë ndërkombëtarë po qëndrojnë në UIBM në kuadër të Programit Erasmus+

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.dr. Alush Musaj, ka pritur në takim prof.asoc.dr. Joze Kortnik dhe prof.ass.dr. Mitja Petriq nga Universiteti i Lubjanës si dhe prof.dr. Malbongëe Manono nga Universiteti “Cape Toën” nga Afrika Jugore, të cilët mbajtën ligjërata me studentë në kuadër të Programit Erasmus + për shkëmbimin e stafit. Ata gjithashtu ishin edhe pjesë e “Kongresit XIX Ballkanik të Përpunimit të Mineraleve (XIX BMPC)”, që u mbajt në Mitrovicë.

Rektori Musaj, i cili në takim shoqërohej edhe nga prorektori, prof.dr. Behxhet Shala dhe dekani i FGJ, prof.dr. Naser Peci, falënderoi mysafirët për angazhimin e tyre në kuadër të Programit Erasmus+. “Jemi shumë të lumtur të ju mirëpresim në Universitetin tonë, ku studentët dhe mësuesit tanë kanë rastin të bëhen pjesë e ligjëratave tuaja”, tha ai.



U konstituua përbërja e re e Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë

Pas përfundimit të zgjedhjeve në Parlamentin Studentor dhe Këshillat e Fakulteteve, të martën u konstituua përbërja e re e Senatit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Në mbledhjen e kryesuar nga rektori, prof.dr. Alush Musaj dhe sekretari i përgjithshëm, Avdyl Beqiri, janë verifikuar mandatet e senatorëve të rinj, të cilët mandej e kanë nënshkruar Deklaratën Etike dhe kanë zgjedhur ass. Milaim Mehmetin, kryesues të përkohshëm të Senatit.

Anëtarë të përbërjes së re të Senatit nga stafi akademik janë: Prof.ass.dr. Nazmi Hasi (Fakulteti i Gjeoshkencave), prof.dr. Aziz Behrami (Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore), Msc. Arbëri Krasniqi (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike), prof.ass.dr. Mimoza Aliu (Fakulteti Juridik), ass. Milaim Mehmeti (Fakulteti Ekonomik) dhe msc.Ylli Hashani (Fakulteti i Edukimit). Senator nga personeli joakademik është zgjedhur, Alban Fazliu, ndërsa nga Parlamenti i Studentëve: Ardenë Hajdini dhe Elmedina Kurti.

Në këtë mbledhje të Senatit u zgjodhën edhe dekanët e njësive akademike: Prof.asoc.dr. Festim Kutllovci (Fakulteti i Gjeoshkencave), prof.asoc.dr. Mensur Kelmendi (Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore), prof.asoc.dr. Faton Mervoci (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike), prof.asoc.dr. Islam Qerimi (Fakulteti Juridik), prof.asoc.dr. Qazim Tmava (Fakulteti Ekonomik) dhe prof.asoc.dr. Samire Bllaca (Fakulteti i Edukimit).



Memorandum Mirëkuptimi me KREN – in

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të përfitojë shërbimet e internetit në kuadër të projektit për Ekonomi Digjitale të Kosovës (KODE), i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë. Për këtë qëllim të enjten është nënshkruar edhe një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet UIBM të përfaqësuar nga rektori prof.dr. Alush Musaj si dhe përfaqësuesve të Kosovo Research and Education Netëork (KREN).

Rektori Musaj, ka falënderuar përfaqësuesit e KREN-it dhe GIZ -it, të cilët ishin të pranishëm në takim ku u nënshkrua edhe Memorandumi i Mirëkuptimit, për mbështetje sa i përket procesit të digjitalizimit. Sipas tij, ky është një hap i rëndësishëm në drejtimin e bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet UIBM dhe KREN-it.



Prof.asoc.dr. Merita Shala zgjedhet Rektore në UIBM



Këshilli Drejtues në mbledhjen e sotme të mbajtur më 24 Korrik 2023 ka zgjedhur prof.asoc.dr. Merita Shala për rektore të ardhshme të UIBM-së në mandatin e ardhshëm 2023/2027. Prof.asoc.dr. Merita Shala është profesoreshë në Fakultetin e Edukimit në UIBM. Në të kaluarën, ka mbajtur pozitën e prorektores dhe dekanes në UIBM. Gjatë mandatit të fundit ka udhëhequr dy herë me radhë procesin e akreditimit institucional me ç'rast për dy herë me radhë UIBM është riakredituar me shumë sukses.

Prof.asoc.dr. Merita Shala ka të kryera dy doktorata dhe mbanë titullin e profesorit të asocuar në UIBM. Ka përvojë të gjatë në arsimin e lartë duke qenë pjesë e projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka publikuar punime shkencore në databazat më të indeksuara botërore duke përfshirë Web of Science dhe Scopus. Ka qenë pjesë e grupeve punuese të ndryshme në nivel të vendit për hartimin e strategjive nacionale lidhur me mbrojtën dhe mirëqenien e fëmijëve.

Prof.asoc.dr. Merita Shala gjatë paraqitjes së ekspozesë para Këshillit Drejtues është zotuar për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të reja që do të jenë unike. Po ashtu, lidhja e universitetit me industrinë do të jetë fokus në mandatin e ardhshëm. Njëra prej pikave kryesore të planprogramit të saj lidhet me parandalimin dhe sanksionimin e konfliktit të interesit, plagjiaturës dhe forcimin e integritetit akademik.

24.07.2023

Marrëveshje Bashkëpunimi me Salem State University nga Massachusetts, USA



Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Salem State University, nga Salem, Massachusetts, SHBA. Në emër të UIBM marrëveshja është nënshkruar nga rektori i UIBM Prof.Dr. Alush Musaj, ndërsa, përfaqësues nga Salem State University ishte Prof.Dr. John Mc Ardle.

Salem State University është një universitet publik në Salem, Massachusetts. Themeluar në 1854, është instituti më i vjetër dhe më i madh i arsimit të lartë në Bregun e Veriut dhe është pjesë e sistemit universitar shtetëror në Massachusetts. Të dyja palët u dakorduan për një bashkëpunim të mirëfilltë me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në fushat e ndryshme që janë në interes së zhvillimit të institucioneve gjegjëse.

UIBM renditet i dyti në mesin e universiteteve publike në Kosovë, sipas Webometriks


Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) vazhdon të mbaj vendin e dytë në mesin e universiteteve publike në Kosovë në ranglistën e Webometriks. Në përditësimin e fundit të publikuar më 28 korrik 2023 nga Webometrics (Spanish National Research Council), UIBM është renditur në vendin e 12 581 në mesin e 31 mijë universiteteve botërore. Në vendin e dytë në raport me universitetet publike në vend, UIBM ka dalur edhe në ranglistën e Webometriks sa i përket citimeve në Google Scholar. Kjo është mirëpritur nga drejtuesit e UIBM, të cilët thonë se tashmë institucioni është i konsoliduar dhe i fokusuar tërësisht në ngritjen e cilësisë.

U përurua Stacioni Hidrometeorologjik në hapësirat e UIBM

Në kampusin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) u përurua Stacioni Automatik Hidrometeorologjik dhe 3 matës automatikë në pronësi të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës. Në përurim përveç rektorit të UIBM, prof.dr. Alush Musaj ishte i pranishëm edhe ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu si dhe drejtues dhe zyrtarë të insitucioneve qendrore dhe lokale. Realizimi i projektit është mundësuar nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe UNDP Kosovo. Këto pajisje do të mundësojnë përpunimin e të dhënave në kohë reale dhe do të luajnë një rol jetik në ndërtimin e modeleve më të sakta të parashikimit të klimës, duke parashikuar më mirë ngjarjet ekstreme të motit si përmbytjet dhe thatësitrat.



Doli nga shtypi monografia “Jeta akademike në Mitrovicë (1961 -2023)”



Ka dalur nga shtypi monografia “Jeta akademike në Mitrovicë (1961 -2023)”, e autorit, Ahmet Jashari, që është botuar nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Monografia është botuar me rastin e 62 – vjetorit të jetës akademike në Mitrovicë si dhe 10 -vjetorit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Monografia për jetën akademike në Mitrovicë, përveç tjerash, është edhe një lloj mirënjohje për të gjithë ata që kanë kontribuar në mënyra të ndryshme, qoftë ish-drejtues, mësimdhënës, studentë apo punëtorë të administratës së atyre institucioneve. Është një epokë e ndërtuar me sakrificat të mëdha, meqë pengesat kanë qenë të mëdha.

Redaktor i monografisë është, PhD(c) Miftar Kurti, recensentë: Arben Veselaj dhe Milaim Shefkiu, ndërsa lektor, Alfred Beka.

UIBM pjesë e Panairit të Punës

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë është bërë pjesë e Panairit të Punës që u organizua të martën nga Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Mitrovicë. Një grup studentësh prezantuan UIBM në një stendë të veçantë në mesin e 29 kompanive sa morën pjesë në panair.

UMIB ka krijuar një traditë të mirë bashkëpunimi me institucione, organizata vendore dhe ndërkombëtare si dhe kompani të shumta private. Kjo ka ndikuar në rritjen e prestigjit të UIBM dhe gjithashtu edhe cilësisë së mësimit.



19.09.2023

U mbajt tryeza me temë: “E ardhmja e Inteligjencës Artificiale në Arsimin e Lartë”

Organizuar nga Zyra Erasmus+ dhe Ekspertët për Reforma në Arsimin e Lartë, u mbajt të enjten në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) tryeza me temën “E ardhmja e Inteligjencës Artificiale në Arsimin e Lartë”. Para të pranishmëve, prof. dr. Blerim Rexha, foli për “Sfidat e përdorimit të AI në arsimin e lartë dhe hulumtimeve shkencore”.

Të pranishmit i kanë përshëndetur fillimisht prorektorja për Buxhet dhe Financa në UIBM, prof.asoc.dr. Ajtene Avdullahi dhe koordinatorja e Erasmus+, Mimika Dobroshi. Prorektorja Avdullahi ka falënderuar Zyrën e Erasmus+ për mbështetjen e vazhdueshme për UIBM.

Në tryezë, përveç prorektorëve të UIBM, ishin edhe dekanët, një numër mësimdhënësish si dhe përfaqësues të studentëve. Ata u bënë pjesë e diskutimeve për temën kyçe në tryezë, duke pasur parasysh rëndësinë e IA në arsimin e lartë dhe hulumtimet shkencore.



Sekretari i përgjithshëm, Avdyl Beqiri, e përfaqësoi UIBM në Konferencën e Arsimit të Lartë në Rotterdam



Sekretari i përgjithshëm i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, Avdyl Beqiri, mori pjesë në Konferencën për Arsimin e Lartë në Rotterdam. Një ndër synimet e kësaj konference është edhe krijimi i kontakteve të institucioneve të arsimit të lartë nga Ballkani Perëndimor me homologët e tyre në Bashkimin Evropian.

Shoqata Evropiane për Arsimin Ndërkombëtar (EAIE) organizon çdo vit një konferencë të madhe në qytete të ndryshme evropiane, ku mbledhin 6000 – 7000 pjesëmarrës nga e gjithë bota që punojnë në fushën e arsimit të lartë. Përveç të qenit një ngjarje rrjetëzimi, kjo konferencë ka gjithashtu një sërë sesionesh plenare, seminare dhe lloje të tjera të ngjarjeve të rrjetëzimit.

Rektori Musaj dhe prorektoret, Shala e Avdullahi, morën pjesë në “Konferencën Ndërkombëtare të Asociacionit të Universiteteve Ballkanike – BUA”

Rektori i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.dr. Alush Musaj, së bashku me prorektoret, prof.asoc. Merita Shala dhe prof.asoc.dr. Ajtene Avdullahi, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Asociacionit të Universiteteve Ballkanike – BUA. BUA u themelua në vitin 2014 dhe aktualisht ka 87 anëtarë. Konferenca e titulluar “Bashkëpunimi Akademik, Sfidat dhe Perspektivat e Ardhshme në Ballkan”, u mbajt më 27 dhe 28 shtator, në Tuzla, organizuar nga Universiteti i Tuzlës.

Katër panele diskutime u mbajtën nga përfaqësues të universiteteve të shumta, anëtarë të Asociacionit me temat: Ndërkombëtarizimi në Universitetet e Ballkanit: Potencialet dhe Sfidat; Roli i Rrjetit Universitar në Integrimin Evropian të Ballkanit; Të rinjtë dhe pjesëmarrja e tyre në Ballkan dhe migrimi në Ballkan: Sfidat dhe perspektivat e së ardhmes.



Memorandum bashkëpunimi për iniciativën “Thunderbird School of Global Management”

Në kuadër të partneritetit të përbashkët dhe ofrimit të mundësive shtesë për studentët, Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Kolegjin Universum për promovimin e “100 Milion Students Global Initiative” të Thunderbird School of Global Management, në kuadër të Universiteti Shtetëror i Arizonës, SHBA. “Iniciativa Globale e Studentëve 100 Milion Studentë” u mundëson studentëve të UIBM dhe partnerëve të tjerë në këtë iniciativë, të ofrojnë arsim të klasit botëror në 40 gjuhë të ndryshme për nxënësit anembanë globit, pa asnjë kosto për nxënësin.

Gjithashtu, studentët e avancuar do të kenë mundësinë të aplikojnë për një bursë të mundshme për të përfunduar studimet master në Thunderbird. Memorandumi është nënshkruar të mërkurën (27 shtator 2023), në Prishtinë së bashku me universitetet tjera nga rajoni. Thunderbird School of Global Management është shkolla më e njohur në botë për mësimdhënien në internet ndërsa Universiteti Shtetëror i Arizonës (ASU) renditet si universiteti më i mirë në SHBA për inovacion. Thunderbird School of Global Management synon të ofrojë arsim falas online për 140,000 studentë në të gjithë rajonin e Ballkanit, në shqip dhe anglisht.



Universiteti “Isa Boletini”- Mitrovicë dhe Universiteti Trakya i bashkohen marrëveshjes së bashkëpunimit akademik

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit arsimor dhe kulturor në fushën e arsimit, kërkimit shkencor dhe aktiviteteve tjera, Universiteti “Isa Boletini”- Mitrovicë, i përfaqësuar nga Rektori, Prof.dr. Alush Musaj dhe Universiteti Trakya të përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erhan TABAKOĞLU, i bashkohen marrëveshjes së bashkëpunimit akademik.

Të dy universitetet do të përpiqen të bashkëpunojnë në arsim dhe kërkim në fusha me interes të përbashkët. Për aq sa është e mundur, të dy universitetet do të inkurajojnë kontaktin dhe bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet anëtarëve të fakultetit, departamenteve, institucioneve kërkimore dhe studentëve.

Bashkëpunimi ndërmjet dy universiteteve përfshin një sërë mundësish, duke përfshirë shkëmbimin e studentëve dhe fakultetit, aktivitete të përbashkëta kërkimore, leksione dhe leksione përmes e-learning, shkëmbim të materialeve të publikuara akademike dhe informacione të tjera, programe të përbashkëta akademike afatshkurtra, si dhe si nisma për trajnimin e stafit, ndër të tjera.



Prof.asoc.dr. Merita Shala, pranoi detyrën e rektores



Prof.asoc.dr. Merita Shala, ka pranuar të hënën zyrtarisht detyrën e rektores së Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) nga rektori i deritanishëm, prof.dr.Alush Musaj. Rektorja Shala ka falënderuar paraardhësin e saj për punën dhe konsolidimin e UIBM.

Ndërsa, ish-rektori Musaj, i ka uruar suksese rektores Shala, në mandatin 4 – vjeçar në krye të UIBM. Shala është rektorja e dytë e UIBM, pas rektorit Musaj, i cili ka udhëhequr universitetin për dy mandate, duke përfshirë edhe periudhën e themelimit.

U mbajt “Dita e pritjes” për studentët e rinj



Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) u mbajt të hënën “Dita e pritjes”, për studentët e rinj që janë regjistruar në vitin akademik 2023/24. Të pranishëm në këtë ceremoni, përveç rektores së UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala, kanë qenë edhe dekanët, prodekanët, mësimdhënës dhe punëtorë të administratës.

Rektorja Shala, ju ka uruar mirëseardhje studentëve të rinj, të cilët prej sot bëhen anëtarë të familjes së UIBM. “Synojmë ta bëjmë UIBM lider të arsimit të lartë në vend dhe rajon në përmbushjen e kërkesave të së tashmes dhe nevojave të së ardhmes”, tha ajo.

Rektorja theksoi se personeli kompetent, administrata e përgjegjshme, kampusi modern, janë avantazhi i UIBM. “Me përkushtimin tuaj gjatë studimeve së bashku mund t’i kthejmë perspektivat në realitet. Sot jemi bërë bashkë për të festuar ditën me festive. Ky është fillimi i një periudhe që do të lë gjurmë në jetën tuaj”, tha rektorja.

Në ceremoni folën edhe kryetarja e Parlamentit Studentor, Ardenë Hajdini, si dhe profesoresha e Fakultetit të Edukimit, Hatixhe Gashi, të cilat uruan studentët e rinj që janë bërë pjesë e UIBM.

UIBM pjesë e punëtorisë “Scientific Journals and Modern Research Methods”



Menaxhmenti dhe stafi akademik i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë kanë marrë pjesë në trajnimet e avancuara dy-ditore të fokusuara në “Scientific Journals and Modern Research Methods”, në kuadër të projektit të Heras+. Këto trajnime janë dizajnuar për të fuqizuar stafin akademik me njohuri të fundit në kryerjen e kërkimeve të prerjes dhe lundrimit në botën e ndërlikuar të revistave shkencore.

Trajnimet përfshinë sesione të thelluara mbi metodologjitë moderne të kërkimit, udhëzime hap pas hapi mbi botimin në revista shkencore me reputacion, sesione mentorimi interaktive që punojnë në shembuj konkretë. Këto nisma trajnimesh janë pjesë e mbështetjes më të gjerë që i ofrohet universiteteve nëpërmjet fondit konkurrues për zhvillimin strategjik të universiteteve publike.

Certifikohen 39 të rinj për “WordPress dhe QA Manual Tester”



Në Qendrën për Inovacion dhe Ndërmarrësi (IEC) të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) u certifikuan 39 të rinj, pasi kanë përfunduar trajnimin e 3-mujor për “WordPress dhe QA Manual Tester”. Drejtori i IEC, prof. Besart Hajrizi, tha se ky është një rezultat fantastik që tregon përkushtimin dhe aftësitë e tyre.

Sipas tij, të rinjtë e certifikuar janë të gatshëm të përballen me sfidat e tregut të teknologjisë së informacionit. “Programi Youth Online and Upëard (YOU) realizohet në kuadër të KODE Projekt, e cila implementohet nga Ministria e Ekonomisë dhe mbështetet nga Banka Botërore”.

Në UMIB u mbajt Shkolla Verore “Post-Mining and Transition”



Në kuadër të projektit hulumtues dhe post-doktoratës “Post-Mining and Transition”, të Prof.Asoc.Dr. Kemajl Zeqiri, të mbështetur nga DAAD gjerman, nga data 24 deri 30 shtator u mbajt pjesa e dytë e shkollës verore në Kosovë dhe Shqipëri. Duhet theksuar se pjesa e parë e shkollës verore, me të njëjtën temë ishte mbajtur në qershor të këtij viti në Bochum të Gjermanisë (Research Centre of Post-Mining). Në këtë shkollë verore morrën pjesë studentë dhe profesorë nga Technische Hochschule Georg Agricola – Bochum Gjermani, Universiteti Politeknik i Tiranës, ndërsa nga UIBM-FGj morrën pjesë Prof.Asoc.Dr. Kemajl Zeqiri (udhëheqës i projektit), ass. Blerina Hasani, ass. Ujmir Uka, ass. Ariana Sadiku dhe studenti Adil Gashi. Përveç ligjëratave tematike, përgjatë shkollës verore u realizuan edhe vizita studimore në terren si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Në fund të shkollës verore u shpërndanë certifikata për pjesëmarrësit.



Rektorja Shala priti në takim drejtuesit e Parlamentit Studentor



Rektorja e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.asoc.dr. Merita Shala e shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm, Avdyl Beqiri, kanë pritur në takim drejtuesit e Parlamentit të Studentëve. Në takim u bisedua për bashkëpunimin ndërmjet menaxhmentit dhe Parlamentit Studentor në të mirë të UIBM.

Kryetarja e Parlamentit Studentor, Ardenë Hajdini, ka uruar rektoren Shala për postin e ri. Gjithashtu ajo është shprehur e gatshme për intensifikimin e bashkëpunimit që ka të bëjë me aktivitetet studentore dhe punën e UIBM në përgjithësi.

Ndërsa, rektorja Shala, ka falënderuar studentët për vizitën dhe është zotuar për vazhdimin e mbështetjes për Parlamentin Studentor.

U mbajt ceremonia e diplomimit për vitin akademik 2022/23

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u mbajt të mërkurën ceremonia e diplomimit për vitin akademik 2022/23. Të pranishëm në këtë ceremoni festive, përveç menaxhmentit, stafit akademik dhe stafit të administratës së UIBM, ishin edhe familjarë dhe mysafirë të shumtë. Rektorja e UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala, ka uruar të diplomuarit dhe familjarët e tyre. Ajo ka shprehur kënaqësinë për arritjet dhe sukseset e studentëve të UIBM, duke i bërë krenarë familjet e tyre si dhe stafin akademik që ka punuar me ta.

Në emër të ish-studentëve, të pranishmëve ju ka drejtuar, Ariona Rushiti, e cila tha se ka qenë kënaqësi me qenë pjesë e UIBM. Ndërsa, studentja senatore, Elmedina Kurti, përgëzoi studentët dhe potencoi faktin e mbështetjes që ofron menaxhmenti i UIBM për studentët.

Ndërsa, Ahmet Jetullahu, foli në emër të organizatës Prishtina REA. Ai u përqëndruara në qasjen e UIBM për bashkëpunim me biznesin, duke ofruar mundësi të mëdha edhe për studentët sa i përket punës praktike, por edhe punësimit.

Të pranishmëve ju drejtua edhe ish – rektori i UIBM, prof.dr. Alush Musaj, i cili uroi të diplomuarit dhe shtoi se ata janë ambasadorët e universitetit, qytetit dhe vendit. “Ju duhet të vazhdoni rrugën e dijes, rrugën e suksesit, për vete dhe për familjet tuaja. Ju duhet të qëndroni në atdhe, ju duhet të ndërtoni jetën këtu, ju duhet ta bëni veten dhe atdheun të lumtur”, tha ai.

Në fund menaxhmenti, dekanët, stafi akademik dhe studentët realizuan foto të përbashkët në ambientet e jashtme të kampusit universitar.

U zgjodh kryesuesi dhe zëvendëskryesuesi i ri i Këshillit Drejtues




Prof.ass.dr. Jeton Halili është zgjedhur kryesues, ndërsa prof.dr. Lirak Karjagdiu, zëvendëskryesues i ri i Këshillit Drejtues të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Ky vendim është marrë të enjten në mbledhjen e KD-së, ku paraprakisht janë verifikuar mandatet e 3 anëtarëve të rinj (prof.dr.sc. Atifete Zuna, prof.ass.dr. Jeton Halili dhe prof.dr. Lirak Karjagdiu), të emëruar për mandatin e mbetur nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Rektorja e UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala, si dhe anëtarët e brendshëm të KD -së, uruan kryesuesin, zëvendëskryesuesin dhe anëtarin e re të KD – së për zgjedhjen e tyre. Mandati i rregullt i KD – së përfundon në vitin 2024.

Pesë studente të UIBM përfunduan me sukses programin “Global Engineer Girls Kosovo”

Pesë studente të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM): Elma Sallahu, Shpresa Bajrami, Albina Demaku, Blerta Jusufi dhe Bleona Feka, kanë përfunduar me sukses programin “Global Engineer Girls Kosovo”. Pjesë e këtij e programi ishin edhe 10 studente nga Universiteti i Prishtinës dhe 5 nga Universiteti i Shkencave të Aplikative në Ferizaj, për të cilat janë ndarë diploma në një ceremoni të organizuar të mërkurën në Prishtinë.

Ky projekt është mundësuar nga partneriteti ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, UNDP Kosovo, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” dhe LIMAK Kosovo. Qëllimi i tij ka qenë që të zhvilloj shkathtësitë ekstrakurrikulare për studentet vajza dhe gra në universitete, me qëllim përgatitjen e tyre për tregun e punës.

Në ceremoninë e ndarjes së diplomave ishin edhe rektorja e UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala dhe sekretari i përgjithshëm, Avdy Beqiri. Rektorja Shala uroi studentet për suksesin e tyre dhe njëkohësisht inkurajoi studentët në përgjithësi që të bëhen pjesë e projekteve që u ndihmojnë në zhvillimin e shkathtësive të tyre që ndërlidhen me tregun e punës.



Filloi punimet “Konferenca V Ndërkombëtare Multidisciplinare për Gjeoshkencë”

Ka filluar të enjten në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) “Konferenca V Ndërkombëtare Multidisciplinare për Gjeoshkencë”, e cila zgjat dy ditë. Konferenca organizohet nga Fakulteti i Gjeoshkencave në UIBM në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministria e Ekonomisë: Departamenti i Minierave dhe Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Konferencën e ka shpallur të hapur rektorja e UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala, e cila ju uroi mirëseardhje hulumtuesve shkencorë dhe mysafirëve nga vendi dhe bota. “Kjo konferencë paraqet një ngjarje të rëndësishme për universitetin tonë, por duke qenë se ka karakter ndërkombëtar gjithsesi është edhe një aktivitet i shënuar në kalendarin shkencor jo vetëm në vend, por edhe më gjerë”, tha ajo.

Ndërsa, koordinatori i konferencës, prof.asoc.dr. Sabri Avdullahi, i cili bëri të ditur se gjatë dy ditëve do të prezantohen gjithsej 19 punime. “Në mesin e atyre që do të prezantohen me punimet e tyre, përveç nga vendi ka studiues nga Kanadaja, Afrika e Jugut, Sllovenia etj., tha ai”.

Me një fjalë rasti të pranishmëve ju ka drejtuar edhe dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, prof.asoc.dr. Festim Kutllavci. Ai tha se kjo konferencë ofron mundësi që të paraqiten idetë dhe zbulimet e reja, duke nxitur njëri-tjetrin për të mbrojtur kualitetin jetësor, duke menaxhuar një zhvillim të qëndrueshëm të resurseve minerale që është një proces i rëndësishëm për ekonominë dhe industrinë e një vendi.

Në ceremoninë hyrëse të pranishmit i ka përshëndetur edhe zëvendësministri i Zhvillimit Ekonomik, Getoar Mjeku. Konferenca ka vazhduar punën në grupe ku kanë filluar prezantimet e punimeve shkencore. Në ditën e dytë të konferencës, do të zhvillohen vizita studimore në minierat e vendit.



U mbajt ligjëratë vetëdijësuese në kuadër të “Tetorit rozë”

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) u mbajt të mërkurën një ligjëratë vetëdijësuese në kuadër të “Tetorit rozë”, si muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Ligjërata u mbajt nga mjeke të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë.

Të pranishmëve fillimisht ju drejtua me një fjalë përshëndetëse rektorja e UIBM, prof.asoc.dr. Merita Shala, e cila falënderoi mjeket e QKMF – së që kanë gjetur kohë për të marrë pjesë në këtë aktivitetet. Ajo potencoi rëndësinë e fushatave informuese sa i përket ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.



Dekani Kutlovci dhe profesori Zeqiri, morën pjesë në punëtorinë “Ballkans Minerals Workshop”

Me ftesë të Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), prof.asoc.dr. Festim Kutlovci dhe mësimdhënësi, prof.asoc.dr. Kemajl Zeqiri, kanë marrë pjesë në punëtorinë “Ballkans Minerals Workshop”. Punëtorja ka zgjatur tre ditë dhe është mbajtur në Sofje të Bullgarisë.

Në kuadër të punëtorisë u prezantuan kumtesa dhe diskutua mbi sfidat dhe mundësitë e prodhimit të metaleve kritike, tregun, strategjitë nacionale dhe baza ligjore e rregullative e vendeve të Ballkanit në kontekstin global zhvillimor. Në fund të punëtorisë pjesëmarrësit kanë realizuar një vizitë në minierën e arit “Cholopech”.





U përruruan pajisjet e reja laboratorike në UIBM

Rektorja e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, prof.asoc.dr. Merita Shala, bashkë me drejtuesin e projektit HERAS+, Aqim Emurli, kanë përruar të hënën pajisjet e reja për laboratorët universitare. Me pajisje janë furnizuar laboratorët e Fakultetit të Gjeoshkencave, Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore si dhe Fakultetit të Edukimit, ku është funksionalizuar Qendra Universitare dhe Komunitare për Mbështetje Psikologjike dhe Mirëqenie.

Paraparakisht, rektorja Shala e shoqëruar nga sekretari i përgjithshëm i UIBM, Avdyl Beqiri, kanë zhvilluar një takim me ekipin e HERAS+ të përbërë nga Aqim Emurli, Donjeta Ibra dhe Nehat Dervishi, ku është biseduar për bashkëpunimin e përgjithshëm si dhe projektin konkret të realizuar në UIBM. Rektorja Shala falënderoi drejtuesit e HERAS+ për realizimin e këtij projekti, që do të krijojë mundësi më të mëdha për punë praktike në UIBM. “Shprehim falënderimin dhe mirënjohjen tonë për mbështetjen e vazhdueshme që ka treguar HERAS+ ndaj UIBM dhe në këtë rast konkretisht për realizimin e projektit për pajisjen e laboratorëve”, tha ajo.

Ndërsa, drejtuesi i projektit HERAS+, Aqim Emurli, vlerësoi korrektësinë e vazhdueshme të drejtuesve të UIBM sa i përket projekteve dhe bashkëpunimit të përgjithshëm.



U mbajt sesion informues me studentët e rinj në UIBM

Studentët që kanë nisur studimet në vitin akademik 2022/23 në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), kanë marrë pjesë të martën në një sesion informues në lidhje me informim, shërbimet studentore, përdorimin e SMU-së, Bibliotekën dhe Qendrën e Karrierës etj. Interesimi i studentëve për këtë sesion informues që u mbajt në Amfiteatrin 1 ishte mjaft i madh.

Të pranishmit i ka përshëndetur drejtori i Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun, Ahmet Jashari, i cili ju ka uruar mirëseardhje dhe i ka njoftuar për mënyrat dhe mjetet që përdoren në UIBM për informimin e studentëve. Në këtë kontekst, ai ka përmendur uebfqen, rrjetet sociale, broshurat, sesionet informuese etj.

Ndërsa, drejtori për Shërbime të Studentëve, Kastriot Xhema, ka folur para studentëve për shërbimet që ofron zyra, si dhe për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Ai kërkoi prej studentëve që të lexojnë edhe rregulloret për përgjegjësitë dhe obligimet që ata kanë.

Zyrtari i administratorit të rrjetit, Zymer Haliti, ua sqaroi studentëve procesin për përdorimin e SMU -së. Ai përmendi modulet që ofron kjo platformë e cila është në dispozicion të studentëve në UIBM.

Udhëheqësi i Bibliotekës Universitare, Alban Fazliu, foli për fondin librar që është në dispozicion të studentëve, për orarin e punës në bibliotekë dhe rregullat e sjelljes gjatë qëndrimit në bibliotekë. Ai gjithashtu ua sqaroi studentëve punën e Qendrës së Karrierës, trajnimet dhe aktivitetet që organizon. Pjesë e sesionit informues ishte edhe Valentina Bajrami nga Zyra për Shërbime të Studentëve dhe Bardhyl Miftari, zyrtar i IT-së.



Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë në top 3 institucionet publike me numër të programeve të akredituara



Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është renditur në top 3 institucionet publike të arsimit të lartë sipas numrit të programeve të akredituara. Kjo renditje ka dalë në Raportin e Monitorimit të Agjencisë për Akreditim dhe Qendrës për Njohje të Diplomave.

Nga të dhënat e siguruara për vitin 2022 rezulton se top 3 institucionet publike me numër më të madh të programeve të akredituara janë: Universiteti “Hasan Prishtina” në Prishtinë me 138 (50% e totalit), Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë me 18 (7%) dhe Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë me 17 (6%). Organizata ORCA, e cila ka monitoruar këtu dy institucione publike, i ka prezantuar raportet në një ngjarje për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Sipas raportit, nga totali i 389 programeve studimore të akredituara, 224 (58%) janë të ofruara nga institucione publike, ndërsa 165 (42%) janë të sektorit privat. Raportet e monitorimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Qendrës Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik, janë realizuar në kuadër të projektit HEI’25.

Projekti financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ang. ADA) me kontribut të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA). Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë: Këto dokumente janë përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

Profesori, Besim Golloperi nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, fitoi çmimin “Ambasador i Paqes”

Profesori i Fakultetit të Edukimit në UIBM fitoi çmimin “Ambasador i Paqes” gjatë Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Kapitali social dhe sfera publike në shoqërinë bashkëkohore”, e mbajtur më 10 dhe 11 nëntor 2023 në Vlorë. Ky çmim u nda nga Federata Universale e Paqes, një organizatë që operon në 120 vende të botës. Tema e prezantimit të profesor Golloperit ishte “Edukimi dhe Paqja”. Konferenca ka përfshirë 245 autorë dhe kooautorë nga 22 vende të ndryshme të botës.



13.11.2023

75

Fakulteti i Edukimit bashkëpunon me “BONEVET Mitrovica” për realizimin e mësimit praktik për studentë



Fakulteti i Edukimit do të bashkëpunojë me “BONEVET Mitrovica”, me qëllim të rritjes së mundësive për studentët sa i përket mësimit praktik. Për konkretizimin e bashkëpunimit është nënshkruar edhe Memorandumi i Bashkëpunimit mes palëve. Dekanja e Fakultetit të Edukimit, prof.asoc.dr. Samire Bllaca, tha se ky partneritet hap rrugë të reja për studentët për t’u angazhuar në përvoja praktike të të mësuarit. “Ky bashkëpunim pasqyron angazhimin tonë për t’u ofruar studentëve një udhëtim arsimor transformues dhe gjithëpërfshirës. Së bashku, ne po formojmë liderët e ardhshëm të gatshëm për suksese në mësime të mësimdhënie”, tha ajo.

“BONEVET” është institucion edukativ i njohur për ofrimin e mundësive në rritje të shkathtësive të studentëve përmes mësimit praktik. Sipas Memorandumit të Bashkëpunimit, “BONEVET”, ndër të tjera ofron: Të mësuarit e aplikuar, zhvillimin e aftësive, rritjen holistike, gatishmërinë për karrierë etj.

Një delegacion nga Universiteti “Nürtingen-Geislingen” vizitoi Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore në kuadër të projektit DualAFS

Në kuadër të projektit DualAFS, një delegacioni i Universitetit “Nürtingen-Geislingen” (NGU) nga Gjermania, i përbërë nga prof. Dirck Einter, prof. Sara Pfaff, Ines Maurmann, Sara Goth, Heiko Eßlinger, vizituan Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, me ç’rast u pritën nga dekani, prof.asoc.dr. Mensur Kelmendi, sekretari i përgjithshëm i UIBM, Avdyl Beqiri dhe menaxheri lokal i projektit, dr. Arbër Hyseni. Ata u njohën me strukturën dhe organizimin në Universitetin “Isa Boletini” Mitrovicë.

Gjithashtu, u diskutua për të arriturat e FTU-së në implementimin e projektit DualAFS. Delegacioni vizitoi klasën hibride, laboratorët e FTU-së si dhe mini fabrikat për përpunimin e qumështit dhe të frutave e perimeve. Pastaj, të shoqëruar nga menaxheri lokal i projektit, dr. Arbër Hyseni, të ftuarit vizituan Muzeun e Qytetit të Mitrovicës gjatë së cilës u njohën me kulturën dhe eksponatet e qytetit.

Delegacioni vizitoi dy ferma në komunën e Vushtrisë, fshatin Reznik dhe Druar. Aty u njohën me kushtet e prodhimit të shtazore, organizimin e fermave, ushqimin e kafshëve që përdoret nga fermerët dhe rendimentin mesatar të prodhimit të qumështit. Në fund shprehën mirënjohjen e tyre ndaj fermerëve për mikpritjen.



Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit Juridik dhe Albanian Institute of Cultural Studies (AICS)

Fakultetit Juridik i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë do të bashkëpunojë me “Albanian Institute of Cultural Studies” (AICS) në Prishtinë. Për këtë qëllim është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi nga dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi dhe drejtoresha Ekzekutive e “Albanian Institute of Cultural Studies” (AICS)-së, dr. Elona Gjata.

Memorandumi i Bashkëpunimit i lidhur mes palëve nënshkruese ka për qëllim krijimin e bazës së bashkëpunimit të dyanshëm përmes realizimit të aktiviteteve në kuadër të projekteve që implementohen nga AICS. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, dekani Qerimi dhe drejtoresha Gjata, vlerësuan se ky memorandum bashkëpunimi do të mundësojë mbajtjen e disa aktiviteteve (tryeza diskutimi, ligjërata) dhe projekteve nga të cilat do të përfitojnë në veçanti studentët e Fakultetit Juridik.

Palët u pajtuan që memorandumi të fillojë sa më parë në zbatimin e tij. Drejtuesja e AICS-s, E. Gjata, pas ceremonisë së nënshkrimit të memorandumit, për studentët e këtij Fakulteti prezantoi një ligjërata të hapur me temë: Kushtetuta e Kaçanikut: Një këndvështrim antropologjik. Kjo ligjërata u përcoll me interesim të madh nga studentët dhe stafi akademik. Znj. Gjata për bibliotekën e këtij Fakulteti dhuroi një ekzemplar të librit “Kosova në 100 fotografi”, me autorë znj. E. Gjata dhe z. H. Ndreu!



U mbajt simpoziumi për nder të “Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve”

Në Fakultetin e Edukimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë është mbajtur të hënën simpoziumi i organizuar në nder të “Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Fëmijëve”. Panelistë në këtë simpozium ishin: dekanja e Fakultetit të Edukimit, prof.asoc.dr. Samire Bllaca, dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi, drejtoresha e Shkollës Fillore “Çajupi”, Melihate Meha, mandej Shemsije Shyti, mësuese dhe Albina Musliu, psikologe.

Simpoziumin e hapi prof.ass. Hatixhe Gashi, e cila tha se qëllimi i këtij organizimi është që të analizohen sfidat aktuale dhe shqyrtimi i mundësive për të përmirësuar mënyrën si shoqëria trajton dhe respekton të drejtat e fëmijëve. “Brenda këtij simpoziumi do të mundohemi të bëjmë një analizë të situatës aktuale të të drejtave të fëmijëve në nivel ndërkombëtar dhe lokal, identifikimin e sfidave aktuale dhe çështjet emergjente që kanë ndikim në të drejtat e fëmijëve në shtetin tonë, rolin e arsimit në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, projekte dhe iniciativa të suksesshme për integrimin e temave të të drejtave të fëmijëve në sistemet arsimore, diskutim mbi strategjitë për mbrojtjen e fëmijëve nga format e ndryshme të dhunës dhe diskriminimit si dhe përvojat e suksesshme dhe sfidat në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”.

Dekanja e Edukimit, prof.asoc.dr. Samire Bllaca, falënderoi panelistët për gatishmërinë e tyre që të bëhen pjesë e simpoziumit si dhe të gjithë pjesëmarrësit tjerë. Ajo theksoi se diskutimet nga profesionistë të fushave të ndryshme sa i përket të drejtave të fëmijëve e pasurojnë këtë simpozium.



Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit Juridik dhe Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë”

Fakulteti Juridik i Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë do të bashkëpunojë me “Fondin për të Drejtën Humanitare Kosovë” (FDHK), në Prishtinë. Për këtë qëllim është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi nga dekani i Fakultetit Juridik, prof. asoc. dr. Islam Qerimi dhe drejtori ekzekutiv i Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë“ (FDHK), Bekim Blakaj.

Memorandumi i Bashkëpunimit i lidhur mes palëve nënshkruese ka për qëllim zyrtarizimin e bashkëpunimit midis këtyre dy institucioneve, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të tyre në fushat përkatëse. Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, dekani Qerimi dhe drejtori Blakaj, vlerësuan se ky memorandum bashkëpunimi do të mundësojë mbajtjen e disa aktiviteteve (tryeza diskutimi, ligjërata, prezantime dhe ekspozita) dhe projekteve nga të cilat do të përfitojnë në veçanti studentët e Fakultetit Juridik.

Dekani Qerimi, tha se në kurrikulën e programit të Fakultetit Juridik janë paraparë një mori lëndësh, ku trajtohen të drejtat e njeriut, rritja e këtij bashkëpunimi ndërmjet të dy subjekteve – palë të këtij memorandumi, do të tregojë efekt në avancimin e shkathtësive të studentëve në këtë sferë të rëndësishme, për sa u përket hulumtimeve dhe projekteve që do të kemi mundësi të konsumojmë në të ardhmen.



U themelua Trupi Këshillëdhënës në Fakultetin Juridik



Dekani i Fakultetit Juridik, prof. asoc. dr. Islam Qerimi më dt. 22.11.2023, organizoi mbledhjen konstituive të Trupit Këshillëdhënës të këtij Fakulteti. Ai, në mbështetje të nenit 68, par. 1. Pika 1.3. të Statutit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, dhe nenit 2 par. 4, si dhe nenit 3. Par. 3 të Rregullores për themelimin dhe mënyrën e funksionimit të Trupit Këshillëdhënës të Njësive Akadematike të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, organizoi mbledhjen konstituive të Trupit Këshillëdhënës për Fakultetin Juridik.

Anëtarët pjesëmarrës të këtij takimi votuan që për mandatin katër vjeçar kryetar i këtij Trupi Këshillëdhënës të zgjedhet zt. Shpëtim Peci i cili ushtron funksionin e Prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Pas konstituimit të Trupit Këshillëdhënës dhe zgjedhjes së kryetarit Peci, Këshilli propozoi që i njëjti Trup të shtohet edhe me prodekanin e posazgjedhur të Fakultetit Juridik, për cilësi dhe marrëdhënie ndërkombëtare, prof.ass.dr. Arbnor Ajeti. Për zgjedhjen e tij, dekani u vendos ta informon këshillin e njësive akademike.

U mbajt konferenca finale e projektit “DualAFS”

Projekti ERASMUS+ Kurrikulat DUALE – Studimi dhe Puna Praktike në Bujqësi dhe Siguri Ushqimore (DualAFS), ka përmbyllur me sukses konferencën finale me temë “Arsimi universitar i dyfishtë – një model premtues për përmirësim trajnimi praktik dhe suksesi në punësim i studentëve në shkencat bujqësore dhe ushqimore”. Konferenca u mbajt në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Universiteti “Isa Boletini” Mitrovicë (UIBM) si një nga partnerët në projektin “DualAFS” u përfaqësua nga rektorja, prof.asoc.dr. Merita Shala, anëtarja e këshillit drejtues, ass. Fatbardha Hoxha, menaxheri lokal i projektit, dr.sc. Arbër Hyseni, profesorët: prof.asoc.dr. Milaim Sadiku, prof.asoc.dr. Valdet Gjinovci dhe sekretari i përgjithshëm i UIBM, Avdyl Beqiri.

Rektorja Shala, në fjalimin përshëndetës falënderoi koordinatoren e projektit Universitetin Nürtingen-Geislingen dhe “Savonia University of Applied Sciences” si dhe universitetet partnere në projekt. Ajo prezantoi UIBM dhe të arriturat gjatë këtij rrugëtimi të suksesshëm. “Përditësimi i kurrikulave, krijimi i klasës hibride përmes së cilës aplikohet mësimi online (e-learning) që ju mundëson studentëve të ndjekin ligjërata nga profesorët e huaj, mobilitetet e studentëve, stafit akademik dhe personelit të laboratorëve, krijimi i njësisë për LLL etj., kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së përmbajtjeve të programit dhe të zbatimit të tij në fakultetin e Teknologjisë Ushqimore”, tha rektorja Shala.



Ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, mbajti ligjëratë në UIBM



Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, shkëlqesia e tij, Jorn Rohde, i shoqëruar nga Christian Bottcher, udhëheqës i Departamentit të Kulturës dhe Shtypit në Ambasadën Gjermane, ka vizituar të enjten Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM). Fillimisht ai është pritur në takim nga rektorja, prof.asoc.dr. Merita Shala, e cila e ka falënderuar për vizitën dhe mbështetjen sa i përket bashkëpunimit me universitetet gjermane. Rektorja Shala, e cila shoqërohej nga dekani i Fakulteti Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi dhe dy anëtarët e Këshillit Drejtues: prof.asoc.dr. Halil Bajrami dhe prof.asoc.dr. Bashkim Bellaqa, e njoftoi ambasadorin për historikun e UIBM, të arriturat dhe sfidat me të cilat përballet ky institucion i arsimit të lartë. U potencua gjithashtu rëndësia e mbështetjes nga ana e ambasadës gjermane lidhur me projektet e ndryshme të arsimit të lartë në vend dhe rajon. Pas takimit me rektoren, ambasadori Rohde, ka mbajtur një ligjëratë me titull: “Raportet gjermano – kosovare dhe gjendja aktuale politike” në Sallën e Konferencave në rektorat, ku kanë qenë të pranishëm mesimdhënës, studentë dhe mysafirë të tjerë. Ai foli për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve dhe mbështetjes që ka dhënë Gjermania për Kosovën në sfera të ndryshme.

U mbajt Akademia Përkujtimore kushtuar prof.dr. Afrim Koliqi

Në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM), u mbajt të premtën Akademia Përkujtimore kushtuar prof.dr. Afrim Koliqi, i cili u nda nga jeta më 16.11. 2023. Të pranishëm në këtë ngjarje përveç drejtuesve të UIBM, ishin edhe familjarë, miq, kolegë dhe mysafirë të tjerë, që nderuan jetën dhe veprën e profesorit të ndjerë, i cili përveç në ish – Fakultetin Xehetaro – Metalurgjik, një kontribut të madh e ka dhënë edhe në Fakultetin e Gjeoshkencave.

Në emër të UIBM të pranishmëve ju ka drejtuar me një fjalë rasti, rektorja, prof.asoc.dr. Merita Shala, e cila ka ngushëlluar familjarët, miqtë dhe kolegët profesorit të ndjerë, Afrim Koliqi. “Ka vetëm pak ditë që profesor Koliqi është ndarë fizikisht nga kjo botë, prandaj dhimbja dhe mërzia janë të freskëta për prindin, familjarin, mikun dhe kolegun tonë. Në raste të këtilla sado që përpiqemi që të gjejmë fjalët më të fuqishme ngushëlluese, ato duken të pafuqishme”, tha ajo.

Dekani i Fakultetit të Gjeoshkencave, prof.asoc.dr. Festim Kutllovci, lexoi biografinë e profesorit të ndjerë, Koliqi. Ai vuri theksin në punën kërkimore dhe shkencore që ka lënë ai. Për të ndjerin ka folur edhe miku i tij, Bajram Mustafa, ndërsa në emër të familjes, të pranishmit i ka përshëndetur dhe falënderuar, e bija e profesorit të ndjerë, Rina Koliqi.

Në shenjë nderimi dhe respekti për jetën dhe veprën e profesorit, Afrim Koliqi, në emër të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, rektorja Shala, ka ndarë mirënjohje “Post – mortum” për ish-profesorin Koliqi, të cilën e ka pranuar e bija e tij, Rina.



UIBM renditet i dyti në kuadër të universiteteve publike nga “Kosovo National H-index Ranking 2023”

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) është renditur në vendin e dytë në kuadër të universiteteve publike në ranglistën e “Kosovo National H-index Ranking 2023”. Edhe në vitin paraprak UIBM ka mbajtur këtë vend në ranglistën e INHR – së.

“Kosovo National National H-index Ranking” është një renditje e pavarur ndërkombëtare që synon të vlerësojë produktivitetin shkencor të shkencëtarëve, grupeve kërkimore dhe organizatave në Kosovë bazuar në H-indeksin e konsoliduar. Rënditja merr parasysh H-indeksin e përgjithshëm të institucioneve shkencore të Kosovës, duke iu referuar informacioneve nga bazat e të dhënave dhe platformat: Scopus, Web of Science dhe Google Scholar.

Bazuar në këto të dhëna, formohet treguesi “National H-index Ranking” dhe pozicioni përkatës në renditje (pozicionet). Në “Web of Science” dhe “Google Scholar”, UIBM ka dalur i dyti, ndërsa në “Scopus” i treti në nivel të universiteteve publike.

Krahasuar me vitin paraprak në vitin 2023 janë dyfishuar publikimet shkencore të stafit akademik të UIBM në “Scopus” dhe “Web of Science”. UIBM ka strategji mbështetjen e stafit akademik në fuqizimin e kapaciteteve kërkimore.

Prof.dr. Naser Peci nga FGJ-ja mori pjesë në takimin vjetor “Initiative for coal regions in transition in the Western Balkans and Ukraine” në Bruksel

Prof.dr. Naser Peci, profesor në Fakultetin e Gjeoshkencave në Universitetin “Isa Boletini në Mitrovicë, mori pjesë në takimin vjetor “Initiative for coal regions in transition in the Western Balkans and Ukraine” që u mbajt me datat 27-28 nëntor 2023 në Bruksel. Takimi është organizuar nga Komisioni Evropian dhe gjashtë partnerë ndërkombëtarë bashkëpunues: Banka Botërore, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Evropiane e Investimeve, Fondi Kombëtar i Polonisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Menaxhimin e Ujërave dhe Kolegji i Evropës në Natolin.

Iniciativa për rajonet e qymyrit në tranzicion në Ballkanin Perëndimor dhe Ukrainë u lansua në dhjetor 2020 dhe synon të ndihmojë vendet dhe rajonet që të largohen nga qymyri drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit, duke siguruar që ky tranzicion të jetë i drejtë. Takimi u organizua në grupe ku panelistë ishin caktuar përfaqësues dhe ekspertë nga vendet e Unionit Evropian si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Ukrainës. Gjatë prezantimeve dhe diskutimeve u shkëmbyen përvojat e vendeve të zhvilluara, atyre të Ballkanit perëndimor dhe Ukrainës për tranzicionin e drejtë.



U mbajt Akademi Përkujtimore kushtuar prof.dr. Mursel Rama dhe prof.dr. Ali Sadiku

Në Fakultetin e Gjeoshkencave në Departamentin Materiale dhe Metalurgji në 3- vjetorin e ndarjes nga jeta të premtën u mbajt Akademi Përkujtimore kushtuar prof.dr. Mursel Rama dhe prof.dr. Ali Sadiku. Në këtë ngjarje përveç drejtuesve të fakulteteve në UIBM dhe të Gjeoshkencave, ishin edhe familjarë, miq, kolegë dhe mysafirë të tjerë, që nderuan jetën dhe veprën e dy profesorëve të Departamentit Materiale dhe Metalurgji, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në Fakultetin e Gjeoshkencave.

Në emër të rektores së UIBM dhe Fakultetit të Gjeoshkencave të pranishmëve ju ka drejtuar me një fjalë rasti, dekani, prof.asoc.dr. Festim Kutllovci, ku ka vlerësuar lartë dy ikona të ndritura të departamentit materiale dhe metalurgjisë të Fakultetit të Gjeoshkencave. Shefi i Departamentit Materiale dhe Metalurgji PhD cand. Bastri Zeka theksoi se prof. dr. Mursel Rama dhe prof.dr.Ali Sadiku kanë qenë profesorë e mentorë, të cilët kanë lënë kështu gjurmë të pashlyeshme duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillim e departamentit Materiale dhe Metalurgji dhe duke lënë pas vete një numër të madh të publikimeve shkencore si dhe një numër të madh të librave në shfrytëzim të studentëve dhe gjithë Departamentit Materiale dhe Metalurgji.

Të pranishmëve ju drejtua edhe prof.dr.Hamit Mehmeti dhe prof.dr.Fehmi Krasniqi, ku vlerësuan lartë dy profesorët si të pashoqë në zhvillimin e Departamentit si dhe në zhvillimin e laboratorëve në kuadër të laboratorit qendror në Universitetit të Prishtinës.

Ndërsa në emër të familjarëve, të pranishmit i ka përshëndetur dhe falënderuar, Drita Rama, e bija e profesorit prof.dr. Mursel Rama si dhe Halil Sadiku, djali i prof.dr.Ali Sadiku.



Memorandum bashkëpunimi ndërmjet FTU-së, K.R.U Gjakova dhe “Kosovo Glass Recycling”

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë (UIBM) do të bashkëpunojë me K.R.U Gjakova dhe “Kosovo Glass Recycling” me qëllim të përshtatshmërisë së sektorit të arsimit të lartë me ato të nevojave të tregut. Për të detajuar fushat e bashkëpunimit trepalësh, u nënshkrua edhe Memorandumi i Bashkëpunimit nga dekani i FTU-së, prof.asoc.dr. Mensur Kelmendi, kryeshefi ekzekutiv i K.R.U. Gjakova, Hasan Krasniqi si dhe pronari i kompanisë “Kosovo Glass Recycling”, Dukagjin Berisha.

Përmes këtij memorandumi të bashkëpunimit palët kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe njohurive profesionale. Dekani Kelmendi, theksoi se qëllimi i këtij bashkëpunimi është që të kontribuohet në ngritjen e relevancës dhe përshtatshmërisë së sektorit të arsimit të lartë me ato të nevojave të tregut si dhe të sigurohet ndikimi pozitiv në rritjen e efektshmërisë së bizneseve në sektorin e inxhinierisë dhe ekonomisë.



Profesori i Fakultetit Juridik, prof.ass.dr. Zahir Çerkini, përfundon programin “Fulbright Visiting Scholar”



Profesori i Fakultetit Juridik, prof.ass.dr. Zahir Çerkini, pasi kishte fituar bursën “Fulbright Visiting Scholar” të Departamentit Amerikan të Shtetit, ka ndjekur për një semestër hulumtimin e postdoktoraturës në fushën e të drejtës kushtetuese, në Fakultetin Juridik dhe Qendrën për të Drejtën Kushtetuese të Drake University në loëa të ShBA-së. Ai u prit në takim nga dekani i Fakultetit Juridik, prof.asoc.dr. Islam Qerimi, i cili e përgëzoi për këtë arritje profesionale.

Dekani Qerimi, theksoi se kjo është një arritje jo vetëm për profesorin Çerkini, por edhe për Fakultetin Juridik dhe Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë. “Përfundimi i programit Fulbright në Fakultetin Juridik dhe Qendrën për të Drejtën Kushtetuese të Drake University në loëa të ShBA-së, do t’i kontribuoj avancimit të mëtutjeshëm të cilësisë dhe performancës së stafit akademik të Fakultetit Juridik, Universitetit si dhe në përgjithësi arsimit të lartë në Kosovë”, tha ai.

Në Fakultetin e Gjeoshkencave nënshkruhen marrëveshje bashkëpunimi me tri shkolla të mesme

Fakulteti i Gjeoshkencave, nën drejtimin e dekanit prof.asoc.dr.Festim Kutllovci dhe me iniciativen e shefit të Departamentit të Materialeve dhe Metalurgjisë, Msc. Batri Zeka PhD Cand, kanë nënshkruar tri marrëveshje me shkollat e mesme në Mitrovicë, Drenas dhe Vushtrri. Ceremonia e nënshkrimit përfshiu pjesëmarrjen e dekanit të Fakultetit, prof. Asoc. Dr Festim Kutllovci dhe drejtorëve Sami Rama, Bashkim Kovaçi dhe Lulzim Nika.

Këto marrëveshje shënojnë një bashkëpunim të rëndësishëm midis Fakultetit dhe shkollave të mesme përkatëse, duke nxitur partneritete që sjellin avantazhe të shumta si për nxënësit ashtu edhe për shkollat. Nxënësit do të përfitojnë nga mundësitë e zgjeruara arsimore, duke fituar qasje në praktika të specializuara, seminare dhe programe të ofruara nga Fakulteti. Për më tepër, vetë shkollat e mesme do të marrin mbështetje në zhvillim dhe aksesin në avancimet më të fundit të Gjeoshkencave, Materiale dhe Metalurgji, Xehetari dhe Gjeologji duke pasuruar përvojën e përgjithshme arsimore.



Stafi i Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore përfundon mobilitetin në Universitetin e Shkencave të Aplikuara Savonia

Në kuadër të projektit DualAFS, Universiteti i Shkencave të Aplikuara Savonia, në Finlandë priti MSc. Shpend Doli (staf-laborant nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë), prej 30 shtator deri më 22 dhjetor 2023 dhe Prof.ass.dr. Mirsade Osmani (staf akademik nga Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë), nga 28 tetor deri më 9 nëntor 2023). MSc. Shpend Doli gjatë qëndrimit të tij u trajnuar në laboratorin e ujit në Kuopio, duke zhvilluar aktivitetet e tij kërkimore përkatëse. Ai avancoi aftësitë e tij laboratorike në lidhje me anionet, kationet dhe matjen e metaleve të rënda në ujë. Gjatë këtij mobiliteti, ai punoi ngushtë me stafin e përfshirë në projektet e hulumtimit të dherave të tokës.

Prof.ass.dr. Osmani gjatë qëndrimit të saj si pjesë e aktiviteteve për qëllime studimore vizitoi objektet në lislami dhe laboratorët në Kuopio dhe u informua për aktivitetet dhe punën e zhvilluar në laboratorët e këtij kampusi, si dhe specifikat që ata përdorin për praktikën më të mira në metodat e mësimdhënies, bazuar në punën praktike. Ajo gjithashtu u njoh me bashkëpunimin e brendshëm dhe pati takime me Grupin Kërkimor për Dizajnimin e Ushqimeve dhe u njoh me punën dhe aktivitetet kërkimore që kryen ky grup. Ata takuan gjithashtu partnerët e Universitetit pritës.



UNIVERSITETI "ISA BOLETINI" – MITROVICË

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun

Adresa: Rr. "Ukshin Kovaçica", 40 000, Mitrovicë

Web: www.umib.net

Email: info@umib.net

Facebook: [Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë](#)

Instagram: [uibm_net](#)

Linkedin: [Universiteti "Isa Boletini" - Mitrovicë](#)

Youtube: [Universiteti "Isa Boletini" – Mitrovicë](#)

Tel: 00383 (28) 535 725

00383 (28) 515 516